



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJII POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 20/2023 regjistër (JR)
Datë 19.05.2023

Nr. 52 i vendimit
Datë 13.12.2023

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Ina Rama	Relatore
Natasha Mulaj	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 13.12.2023, ditën e mërkurë, në orën 14:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Komisionerja Publike, Irena Nino.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 634, datë 10.03.2023, për subjektin e rivlerësimit Naim Tota, me funksionin prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; si dhe neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shqyrtoi pretendimet e kërkimet e Komisioneres Publike të paraqitura në ankim dhe në konkluzionet përfundimtare, e cila kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit objekt shqyrtimi dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit

Naim Tota, subjektin e rivlerësimit, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit, dëgjoi relatorin e çështjes, gjyqtaren Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Naim Tota (në vijim “subjekti i rivlerësimit), në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe për shkak të parashikimeve të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex-officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), për subjektin e rivlerësimit administroi raportet e vlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

2.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar pranë Komisionit raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit dhe vlerësimit të pasurisë së subjektit Naim Tota, në të cilin në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK-ja i ka përcjellë Komisionit raportin e kontrollit të figurës², duke konstatuar, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Naim Tota.

2.3 KLP-ja, për subjektin e rivlerësimit Naim Tota, i ka përcjellë Komisionit një raport³ të hollësishëm për vlerësimin e aftësive profesionale.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, me vendimin nr. 634, datë 10.03.2023, në bazë të germës “a”, të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikave 1 dhe 4, të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Naim Tota, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Këtë vendim, Komisioni e ka mbështetur mbi rezultatet e hetimit

¹ Me shkresën nr. {***} datë 29.10.2018.

² Me shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar me vendimin nr. {***}, datë 17.6.2022, të KDZh-së.

³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 30.11.2022.

administrativ në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, për të cilët ka konkluduar se:

3.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: [...] Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë e konstatuara dhe balancat negative të fondeve të rezultuara për disa vite nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, Komisioni, gjatë hetimit administrativ, konstatoi se pasaktësitë e konstatuara dhe balancat negative të fondeve për disa vite të caktuara nuk kanë ndikuar në mënyrë thelbësore në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit. Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklarimet e pasakta të konstatuara si më sipër dhe problematikat e evidentuara në analizën financiare, nuk çmohen të mjaftueshme për cenimin e kriterit të pasurisë apo të vlerësohen si të tilla që të ndikojnë në vlerësimin tërësor në procesin e rivlerësimit të kryer për këtë subjekt. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut të drejtësia, pasi vlerësimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Naim Tota ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

3.2 Për kriterin e kontrollit të figurës: [...] Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin e subjektit të rivlerësimit Naim Tota, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

3.3 Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: [...] Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, denoncimeve të depozituara nga publiku dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

4. Komisionerja Publike Irena Nino, në konsideratë të aktit⁴ “Rekomandim për paraqitje ankimi”, të nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit

⁴ Të përcjellë pranë Institutit të Komisionarëve Publik më datë 02.05.2023.

Ndërkombëtar të Monitorimit, ka paraqitur ankim kundër vendimit nr. 634, datë 10.03.2023, të Komisionit, i cili ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit Naim Tota.

5. Komisionerja Publike ka parashtuar në ankim se nëpërmjet këtij mjete procedural, në respektim të kërkesave kushtetuese e ligjore për rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, në mbrojtje të interesit publik, synon kontrollin e vendimit nr. 634, datë 10.03.2023, të Komisionit nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim Kolegji). Nëpërmjet ankimit Komisionerja Publike ka kundërshtuar konkluzionet e Komisionit për kriteret e vlerësimit të pasurisë dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, duke kërkuar nga Kolegji ndryshimin e vendimit nr. 634, datë 10.03.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Naim Tota.
6. Referuar përmbajtjes së ankimit të Komisioneres Publike, shkaqet e ankimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

A. Shkaqe lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

6.1 Komisionerja Publike konsideron jo të drejta konkluzionet e Komisionit për marrëdhënien që subjekti i rivlerësimit ka me pasurinë apartament banimi 2+1, në rrugën “{***}”, në Tiranë, duke pretenduar se gjatë hetimit administrative ai nuk ka mundur të rrëzojë konstatimet e Komisionit, për të cilat i ka kaluar barra e provës, pasi: **(i)** subjekti i rivlerësimit nuk mundi të shpjegojë arsyet e sjelljes si pronar *de facto* i kësaj pasurie që nga viti 2003; **(ii)** subjekti i rivlerësimit nuk mundi të provojë që i afërmi i tij (z. T.H.), i cili më pas me kontratën e cedimit të të drejtave i kaloi pronësinë mbi këtë pasuri subjektit të rivlerësimit, kishte të ardhura të ligjshme për të financuar blerjen e kësaj pasurie në vitin 2003; **(iii)** çmimi i blerjes/përfitimit nga subjekti i rivlerësimit i kësaj pasurie në vitin 2016 nëpërmjet kontratës së cedimit, duke qenë i njëjtë me atë të blerjes nga ceduesi 12 vite me parë, kur vlera e këtij apartamenti në tregun e lirë është 3-fishuar, është një e dhënë e cila shton argumentet që subjekti i rivlerësimit ka qenë pronari i këtij apartamenti që nga viti 2004; **(iv)** ka paqartësi për ekzistencën e marrëdhënies së huadhënies që subjekti ka pasur në vitin 2008 me z. T.H..

6.2 Lidhur me burimet e krijimit të të ardhurave të shumës 40.000 euro, të krijuara si rezultat i shitjes së aksioneve të bashkëshortes së ndjerë të subjektit të rivlerësimit, në shoqërinë {***} ShA, dega Kosovë, Komisionerja Publike pretendon se: **(i)** subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja nuk kanë deklaruar në deklaratat vjetore periodike (në vijim “DVP”) blerjen e aksioneve të shoqërisë {***} ShA, gjithashtu, subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* (në vijim “deklarata *vetting*”), burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e fondit të përdorur për investimin në aksione në vitin 2005, duke mos deklaruar as në DVP dhe as në deklaratën *vetting* se motra e subjektit (M. D.) dhe motra e bashkëshortes së tij (R. M.) janë huadhënëse të bashkëshortes; **(ii)** subjekti i rivlerësimit, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk mundi të provojë se personi tjetër i lidhur, motra e bashkëshortes, kishte burime të ligjshme për të krijuar shumën e dhënë hua bashkëshortes së subjektit, si edhe nuk arriti të provojë ligjshmërinë e shumës së dhënë hua prej motrës së tij, të cilat ajo i ka përdorur për blerjen e aksioneve në shoqërinë {***} ShA, Kosovë.

6.3 Komisionerja Publike kundërshton si jo të drejtë dhe në përputhje me situatën faktike analizën ekonomike të bërë nga Komisioni për periudhën 2003-2016, për mundësinë e subjektit

të rivlerësimit për të mbuluar me të ardhura të ligjshme investimet e kryera dhe kostot e jetesës, duke pretenduar se analiza ekonomike e Komisionit ka pasaktësi në disa zëra, të cilët janë përlllogaritur jo sipas standardeve të organeve të rivlerësimit të aplikuarra deri tani.

6.4 Komisionerja Publike pretendon se subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*, si dhe në deklaratimet periodike vjetore ka bërë deklaram të pasaktë për pasurinë tokë bujqësore në pronësi të tij, të përfituar nga ligji nr. 7501/1991, si dhe të pasurive të paluajtshme të personave të lidhur (fëmijëve të tij), të cilat i kanë përfituar me zëvendësim nga trashëgimia ligjore e gjyshit të tyre, duke u gjendur për pasojë në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë në kundërshtim me përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

B. Shkaqe lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

6.5 Komisionerja Publike pretendon se në shqyrtimin e procedimit penal nr. {***}, që lidhet me denoncimin e shtetasit Q. D., si dhe në shqyrtimin e procedimit penal nr. {***}, që lidhet me denoncimin e shtetasit A. M., subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përsëritur (duke konsideruar edhe denoncimet e ardhura nga denoncuesit E. D., F. Y. dhe M. Z.), ka treguar të meta të dukshme, mungesë arsytimi, mungesë hetimesh dhe mosrespektim të vendimmarrjes së gjykatave, mangësi këto që duhen vlerësuar në raport me përmbushjen e standardeve të përcaktuara nga nenet 73 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 96/2016), dhe në vlerësimin në tërësi të çështjes në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

7. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, i parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim që i përket subjektit të rivlerësimit Naim Tota, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisioneres Publike dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

b) Legjitimimi i ankuesit

8. Komisionerja Publike legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

9. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi nga Kolegji i ankimit ndaj vendimit nr. 634, datë 10.03.2023, të Komisionit, duke qenë se është ushtruar nga Komisionerja Publike, u zhvillua në seancë gjyqësore publike.
10. Në Kolegj, pas regjistrimit të çështjes objekt gjykimi, janë administruar denoncimet e shtetasve B. M.⁵ dhe Th. S.⁶ që i adresoheshin subjektit të rivlerësimit Naim Tota, të cilat ju bënë me dije atij para fillimit të shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Për këto denoncime, subjekti i rivlerësimit, në seancën gjyqësore të datës 30.11.2023, paraqiti shpjegimet e tij dhe aktet në mbështetje të tyre.
11. Trupi gjykues, pasi u njoh me qëndrimin e Komisioneres Publike lidhur me denoncimet, sipas së cilit, vlerësohet se mangësitë profesionale në drejtim të aspektit të njohurive, arsytimit dhe mungesës së hetimeve qëndrojnë dhe se ato duhen vlerësuar sipas nënindikatoreve të neneve 73 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si edhe me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit Naim Tota, në konsideratë edhe të akteve të paraqitura në mbështetje të këtyre shpjegimeve, çmoi të ezauruar fazën e verifikimit të tyre dhe vlerësoi se informacioni i përcjellë nëpërmjet tyre nuk plotësonte kriteret e parashikuara nga neni 53 i ligjit nr. 84/2016 e nuk krijonte bindjen për shkeljet ligjore të pretenduara se janë kryer nga subjekti, për pasojë vendosi të mos i hetojë ato më tej në funksion të zgjidhjes së çështjes.
12. Në përfundim të hetimit gjyqësor, trupi gjykues vlerësoi shkaqet e ngritura në ankim dhe pretendimet përfundimtare të Komisioneres Publike, duke analizuar e çmuar të gjitha provat që gjendeshin në fashikullin e hetimit administrativ të krijuar nga Komisioni, si dhe ato të cilat u morën gjatë procesit gjyqësor dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor prej palëve.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit nga Kolegji

i. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

13. Trupi gjykues i Kolegjit mori në shqyrtim dhe ia nënshtrou analizës së tij shkaqet e ankimit, mbi të cilat u mbështet Komisionerja Publike, si arsye për të cilat duhej të vendosej ndryshimi i vendimit të Komisionit, objekt shqyrtimi.

13.1. Në përmbledhje të shkaqeve të ankimit lidhur me pasurinë apartament banimi në rrugën “{***}”, në Tiranë, Komisionerja Publike ka pretenduar se *mbështetur në analizën e fakteve dhe rrethanave si më sipër, duke vlerësuar sjelljen e subjektit në raport me këtë pasuri, çmon se subjekti i rivlerësimit ka qenë poseduesi dhe pronari de facto i këtij apartamenti, që prej vitit 2004, duke e legalizuar/formalizuar këtë marrëdhënie vetëm në vitin 2016. Rrethanat e mësipërme çojnë në aplikimin e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, situatë e cila duhet të vlerësohet edhe në vështrim të nenit 4, pika 2, në lidhje me nenin 61, pika 5 e këtij ligji.* Kolegji mori në shqyrtim pretendimet e ankimit

⁵ Të regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 28.06.2023.

⁶ Të regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 22.11.2023.

që i adresohen pasurisë apartament banimi të ndodhur në rrugën “{***}”, në Tiranë, sipas analizës për secilën çështje në vijim të këtij arsyetimi.

13.2. Trupi gjykues mori fillimisht në shqyrtim pretendimin e Komisioneres Publike se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të përmbysë barrën e provës, për sa i përket shpjegimit të arsyeve të sjelljes së tij si pronar *de facto* i kësaj pasurie që në vitin 2004, si një nga elementët mbi të cilët është ngritur dyshimi se kjo pasuri ka qenë e tij që në fillimet e krijimit të saj. Lidhur me këtë pretendim, konstatohet se Komisioni ka arritur në përfundime konfirmuese të shpjegimeve të subjektit lidhur me këtë situatë, duke konsideruar se ai e kishte bindur Komisionin për sa i takon sjelljes në dukje si pronar i kësaj pasurie, si veprime të kryera në mirëbesim e në përputhje me marrëdhëniet e posaçme që ekzistonin mes subjektit e familjes së motrës së tij, veçanërisht në kontekstin e situatës së vështirë jetësore në të cilën u gjend familja e subjektit pas humbjes së të ndjerës, bashkëshortes së tij. Në vendimin e Komisionit, në përfundim të analizës të elementëve që formësojnë këtë shkak ankimi është konkluduar se mospërdorimi i kësaj pasurie nga blerësi fillestar nuk mund të shërbejë si një rrethanë e vetme mbi të cilën të arrihet në konkluzionin se kjo pasuri nuk ka qenë e tij. Ndërsa subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri si adresën e tij të banimit për të gjithë periudhën që ka banuar në të, duke demonstruar në këtë mënyrë se ai nuk ka pasur asnjëherë qëllim për fshehje të saj. Komisioni ka arritur në përfundimin se marrëdhënia faktike e subjektit me këtë pasuri nuk është një element i mjaftueshëm për të konkluduar se ai ka qenë pronari *de facto* i saj. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë pretendim në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, ka shpjeguar se apartamenti në rrugën “{***}”, në Tiranë, është marrë në përdorim nga familja e subjektit në fund të vitit 2004 dhe fillimit të vitit 2005, për shkak të regjistrimit të fëmijëve në shkollë, pasi paraprakisht motra e subjektit dhe kunati i kishin ofruar familjes së z. Naim Tota që të banonin në këtë apartament, pasi ata vetë zotëronin një banesë tjetër në zonën e {***}, në Tiranë. Gjithashtu, subjekti shpjegon se në atë periudhë ka qenë i komanduar në disa rrethe të Shqipërisë dhe kjo ka qenë edhe arsyeja e vendosjes së familjes në Tiranë.

13.3. Nga analiza e akteve në fashikullin e hetimit administrativ, rezulton se nga subjekti i rivlerësimit për apartamentin në rrugën “{***}”, në Tiranë, në deklaratën *vetting* është deklaruar: *Apartament banimi 2+1, i ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, përfituar me kontratën e cedimit të datës 16.3.2016, me vlerë 50.000 USD. Burimi i krijimit: (i) të ardhurat në shumën 5.000.000 lekë, të përfituara nga shitja e apartamentit në Kukës; (ii) të ardhurat dhe kursimet ndër vite.* Subjekti ka bërë deklarime të ngjashme për formalizimin e marrëdhënies së tij me këtë pasuri në DVP-të për vitet 2016 e 2017.

13.4. Nga analizimi i deklaratave periodike ndër vite, konstatohet se prej subjektit të rivlerësimit, në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2003, deklarohet se banon në qytetin e Kukësit, ndërsa në DVP-në 2004 e në vijim ai ka deklaruar si adresë banimi atë, mbi të cilën është regjistruar edhe gjendja civile e familjes tij “*Njësia nr. {***}, rruga “{***}”, Tiranë*”, e cila përputhet me adresën e apartamentit 2+1 të ndërtuar nga shoqëria e ndërtimit “{***}” ShPK dhe të deklaruar si në pronësi në deklaratën *vetting*. Nga sa evidentuar më sipër, rezulton se në asnjë prej DVP-ve subjekti nuk ka deklaruar/shpjeguar mbi mënyrën/formën me të cilën ai ka siguruar banesën e tij dhe të familjes, në apartamentin në rrugën “{***}”, në Tiranë, me përjashtim të deklarimit të bërë nga subjekti në DVP-në e vitit 2008, në të cilin ai, krahas vendosjes së këtij apartamenti në rubrikën e adresës së banimit, ka bërë shënimin *me qira*, por

i pa shoqëruar me ndonjë akt që konfirmon këtë marrëdhënie. Për të gjitha vitet e tjera të deklarimit, me adresë banimi në të njëjtën pasuri, subjekti nuk ka shpjeguar asnjëherë se cila është marrëdhënia e tij me këtë pronë dhe si ka lindur ajo.

13.5. Ndonëse konstatohet se në DVP-në 2008 subjekti deklaroi se jeton në këtë apartament me qira, që sipas përcaktimeve të nenit 801 e vijues të Kodit Civil është një marrëdhënie e krijuar midis qiradhënësit e qiramarrësit për dhënien në përdorim të sendit/pasurisë së paluajtshme kundrejt një shpërblimi të caktuar rezultoi se në vitin 2016, i pyetur nga ILDKPKI-ja, subjekti ka deklaruar se nuk ka lidhur kontratë qiraje për këtë pasuri, pasi personit që ka blerë këtë apartament z. T.H., i ka dhënë hua shumën 40.000 euro, marrëdhënie e cila trajtohet në vijim në këtë vendim si një element tjetër me ndikimin në ngritjen e dyshimeve për pasuri të fshehur të subjektit.

13.6. Përveç të dhënave që përftohen nga deklaratat e subjektit në deklaratat periodike të pasurisë, trupi gjykues konstaton se gjatë hetimit administrativ në Komisionin subjektit në përgjigje të rezultateve shtesë të hetimit⁷ ka shpjeguar se ka paraqitur prova shkresore të cilat provojnë porositjen dhe kryerjen e pagesave në vitin 2003 për këtë pasuri, nga z. T.H., i cili ia ka ofruar për banim subjektit në vitin 2004, meqenëse kishte një banesë tjetër në zonën e {***}, po në Tiranë. Nga këto akte dhe deklarime të subjektit rezultoi se edhe pse z. T.H., me anën e kontratës së sipërmarrjes⁸ të datës 03.04.2003, e kishte blerë apartamentin në rrugën “{***}”, në Tiranë dhe shlyer plotësisht po në këtë vit çmimin e tij, ai ka vijuar të jetojë në një banesë private që, në të njëjtën periudhë, ishte duke ndërtuar në zonën e {***} në Tiranë. Lidhur me këtë situatë faktike të shpjeguar nga subjekti, trupi gjykues konstaton se përpara se subjekti të jepte shpjegimet mbi rezultatet shtesë të hetimit administrativ, vetë Komisioni kishte siguruar të dhëna të ndryshme mbi banimin e familjes H., pasi nga ky organ më datë 09.01.2023 është marrë në pyetje z. T.H., të cilit i është kërkuar të sqarojë marrëdhënien e tij me subjektin e rivlerësimit dhe rrethanat e blerjes së apartamenti në rrugën “{***}”. Në përgjigje të pyetjeve të Komisionerëve dhe të Vëzhguesit Ndërkombëtar, z. H., ndër të tjera, ka sqaruar se në Tiranë banonte me qira deri sa ndërtoi shtëpinë te zona e {***} në vitet 2002-2003 dhe se para se të blinte apartamentin në rrugën “{***}”, në Tiranë, por edhe pasi e bleu atë jetonte me qira, po në Tiranë, në një apartament në rrugën “{***}”.

13.7. Faktet e mësipërme të deklaruara prej vetë personit që i ka jetuar ato, personalisht, pasqyrojnë situatën faktike lidhur me këtë pasuri, e cila i jep kuptim dyshimeve të ngritura prej Komisionit në fillim e më pas prej Komisioneres Publike se subjekti është sjellë si pronar i saj që në fillimet e krijimit. Subjekti i rivlerësimit ka qenë banori i parë *de facto* i kësaj prone, edhe pse porositësi i saj formal, z. H., vijonte të jetonte me qira në kohën që apartamenti u ble prej këtij të fundit dhe u bë i banueshëm prej subjektit, pavarësisht investimit të bërë në të nga kunati,

⁷ Të administruara në Komision me nr. {***} prot., datë 06.03.2023.

⁸ Në kontratën e sipërmarrjes të nënshkruar mes palëve është përcaktuar se vlera totale e apartamentit do të jetë 50.000 USD dhe se do të likuidohet me këste, e përkatësisht: (i) kësti i parë në vlerën prej 25.000 USD në datën e nënshkrimit të kontratës (datë 03.04.2003); (ii) kësti i dytë në vlerën prej 10.000 USD, brenda datës 30.06.2003; dhe (iii) kësti i tretë në vlerën prej 15.000 USD, brenda datës 30.10.2003. Gjithashtu, në këtë kontratë është specifikuar se apartamenti objekt transaksioni do t'i dorëzohet porositësit brenda muajit maj të vitit 2004. Bashkëlidhur me kontratën e sipërmarrjes së datës 3.4.2003, evidentohen 3 mandatpagesa pjesërisht të lexueshme nga ku duket se z. T. H. ka likuiduar plotësisht gjatë vitit 2003 shumën prej 50.000 USD, në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, e përkatësisht: (i) në datën 03.04.2003, shumën prej 25.000 USD; (ii) në datën 26.06.2003, shumën prej 10.000 USD; dhe (iii) në datën 29.12.2003, shumën 15.000 USD.

i cili, siç ai vetë ka deklaruar, kishte synime krejt të ndryshme për të zgjidhur problemin e strehimit në qytetin e Tiranës dhe që i realizoi nëpërmjet ndërtimit të një banese te zona e {***}

13.8. Trupi gjykues vlerëson se qëndrimi i Komisionit, lidhur me faktin e përdorimit të apartamentit prej subjektit, sipas së cilit [...] çmon se në asnjë rast kjo rrethanë nuk mund të shërbejë si e vetme në ngritjen e situatës së dyshuar për fshehje pasurie, nuk mund të jetë një arsye e vlefshme, pasi vetë Komisioni rendit dhe analizon një sërë elementësh për të përjashtuar dyshimet për pasuri të fshehur. Marrëdhënia e subjektit me këtë pasuri, pa kundërshtim e në mënyrë të pandërprerë prej 12 vitesh, sigurisht që është elementi bazë mbi të cilin janë ngritur dyshimet, siç edhe vetë Komisioni e ka kualifikuar në rezultatet e hetimeve paraprake, por ai nuk është i vetmi element për t'u konsideruar, por duhet të vlerësohet në harmoni me të gjithë të dhënat e tjera të dala nga hetimi.

13.9. Në përmbledhje të të dhënave që merren në analizë në funksion të këtij shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson të evidentojë si vijon: (i) subjekti i rivlerësimit, që prej momentit të vendosjes së tij në posedim të kësaj pasurie në vitin 2004, bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike” i ndryshuar (në vijim ligji nr. 9049/2003), duhet të deklaronte në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 marrëdhënien juridike nga i buronin këto të drejta reale apo fruta civile të sendit, deklarim i cili nuk është kryer në kundërshtim me detyrimet e ligjit të sipërcituar; (ii) sjellja e subjektit të rivlerësimit me pronën, gëzimi dhe përdorimi i saj jo prej pronarëve të pretenduar, por vetëm prej subjektit të rivlerësimit dhe familjes së tij, në raport me gjithë provat e tjera të analizuara, duket se qëndron në një raport të zhdrejtë, për sa i përket asaj që subjekti pretendon apo ofron në këmbim të këtij përfitimi. Sipas akteve në dosje, rezulton se pronarët *de jure* të pasurisë kanë investuar për fitimin e pronësisë së saj një shumë të konsiderueshme në vitin 2003, rreth 50.000 USD, duke shpenzuar për këtë pasuri një pjesë të rëndësishme të të ardhurave të tyre, të cilat rezultojnë të jenë të kufizuara, edhe mbështetur në shpjegimet që vetë subjekti ka dhënë. Familja e motrës së subjektit ka jetuar me të ardhura nga puna, e cila është pretenduar se ka prodhuar edhe shpërblime të tjera veç pagës, si komisione të paprovuara në proces, por që edhe në versionin që jep subjekti nuk përfaqësojë në asnjë rast vlera të tilla që do të bënin indiferentë krijuesit e tyre, për investimin në këtë vlerë dhe mospërdorimin e pronës, për një periudhë kaq të gjatë kohe. Nga hetimi ka rezultuar se porositi/blerësi i kësaj pasurie, i ndjeri z. T.H., jo vetëm nuk e ka përdorur asnjëherë pasurinë objekt analize për nevojat e tij apo të familjes së tij, por sipas dëshmisë së tij, dhënë përpara Komisionit, ai ka jetuar me qira në momentin e blerjes së pasurisë apartament, deri në momentin kur ai ka ndërtuar banesën private të tij, ndodhur në zonën e {***}, Tiranë, ku dhe ka banuar përgjatë gjithë kohës deri në zhvillimin e hetimit nga Komisioni.

13.10. Për sa më lart, trupi gjykues çmon se është i drejtë dhe i mbështetur në situatën faktike pretendimi i Komisioneres Publike se subjekti i rivlerësimit, për sa i përket përdorimit dhe sjelljes si pronar me apartamentin në rrugën “{***}”, në Tiranë, nuk ka mundur të japë një shpjegim të logjikshëm dhe bindës, i cili të rrëzojë konstatimet e arritura në përfundim të hetimit administrativ nga Komisioni, të cilat e konsiderojnë atë si pasuri *de facto* të tij, siç kërkon neni 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

13.11. Lidhur me pretendimin e Komisioneres Publike se subjekti nuk mundi të provojë që i afërmi i tij T.H. të kishte të ardhura të ligjshme për të financuar blerjen e kësaj pasurie në vitin 2003, trupi gjykues analizon sa vijon.

13.12. Nga aktet e administruara në dosje, rezulton se Komisioni pas zhvillimit të seancës së parë dëgjimore të datës 23.02.2023, ka vendosur riçeljen e hetimit administrativ për kryerjen e një analize financiare me qëllim evidentimin e mundësisë financiare të z. T.H. për të paguar me burime të ligjshme pasurinë objekt kontrolli. Për këtë qëllim, bazuar në nenin 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni i ka përcjellë subjektit të rivlerësimit rezultatet shtesë të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës për të provuar të kundërtën e këtyre rezultateve, për sa i përket pamundësisë financiare të z. T.H. për krijimin e pasurisë apartament dhe likuidimin e çmimit të kësaj pasurie në vitin 2003.

13.13. Në përgjigje të kësaj barre prove, subjekti i rivlerësimit me përgjigjet për rezultatet shtesë të hetimit ka deklaruar disa burime financimi të përdorura prej z. T.H., të cilat janë konsideruar dhe vlerësuar prej Komisionit në funksion të analizës financiare, si vijon: **(i)** të ardhurat nga paga dhe komisionet e përfituara nga z. T.H., si i punësuar në sektorin e sigurimeve; **(ii)** të ardhurat nga puna e motrës së tij, znj. I. H. (T.), bashkëshortja e shtetasit T.H.; **(iii)** të ardhurat e përfituara nga shitja e dy banesave (njëra së bashku me truallin), në qytetin e Kukësit; **(iv)** të ardhurat e përfituara nga shtetasi T.H. si rezultat i kryerjes së aktivitetit të këmbimit valutor; **(v)** likuiditetet në “Raiffeisen Bank”⁹, si dhe ato të mëparshmet, të cilat, sipas subjektit, tregojnë se shtetasi T.H. ka tërhequr të ardhura në kohën kur ka paguar këstet e apartamentit në rrugën “{***}”, Tiranë. Pasi ka kryer analizën e familjes H., duke konsideruar këto burime të ardhurash për financimin e apartamentit në rrugën “{***}”, në Tiranë, Komisioni ka konkluduar se [...] në shqyrtim dhe analizë të shpjegimeve, provave dhe rrethanave të evidentuara mbi të ardhurat dhe burimet financiare të familjes H., trupi gjykues vlerëson se ata kanë pasur një situatë të shëndetshme financiare, pra se ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer gjatë vitit 2003 për likuidimin e çmimit të blerjes së apartamentit në Tiranë. Ky konkluzion sigurisht që duhet pranuar se është arritur në kushtet e një niveli më të ulët provueshmërie, për sa kohë shtetasi T.H. nuk bën pjesë në rrethin e personave të lidhur, sipas parashikimit të bërë në pikën 13, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, apo në rrethin e personave të tjerë të lidhur, në kuptim të nenit 32/4 të po këtij ligji dhe, si rrjedhojë, nuk kërkohet që të përmbushet detyrimi kushtetues për justifikimin e ligjshmërisë së pasurive, sipas nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, duke sjellë në vëmendje këtu se analizimi i burimeve financiare të familjes H. për blerjen e kësaj pasurie është kryer në funksion të verifikimit të situatës së dyshuar për pasuri të fshehur.

13.14. Komisionerja Publike në ankim kundërshton konkluzionet e Komisionit për burimet e financimit të apartamentit në rrugën “{***}”, në Tiranë, nga blerësi fillestar T.H., duke pretenduar se në analizën financiare të kryer Komisioni ka marrë në konsideratë apriori pretendimet e subjektit të pambështetura në aktet e administruara në dosje, duke arritur në përfundimin e gabuar që kunati i subjektit të rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e pasurisë me vlerën 50.000 USD, pasi: **(i)** gjendet i gabuar vlerësimi i Komisionit

⁹ Për këtë qëllim, subjekti ka paraqitur si provë dokumentin “Kthim përgjigje” nr. {***} prot., datë 03.02.2023, të lëshuar nga “Raiffeisen Bank” lidhur me dy depozita bankare.

mbi përfshirjen në mesin e burimeve të ligjshme të familjes H. të të ardhurave shtesë të pretenduara si të përfituara në formën e komisioneve/bonuseve nga punësimi pranë shoqërive të sigurimeve {***} ShA dhe {***} ShA, mbështetur vetëm në deklaratat e këtyre dy shoqërive të lëshuara gjatë hetimit administrativ, të cilat për më tepër nuk referojnë as vlerë/shumë të përfituar. Këto të ardhura, sipas Komisioneres Publike, mbeten në nivel deklarativ dhe nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës; (ii) gjendet e pabazuar përfshirja në analizë nga Komisioni i shumave të përfituara të z. T.H., nga shitja e dy pronave në Kukës, sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për një vlerë 2.5 herë më të lartë se vlera e përcaktuar në kontratat respektive noteriale të depozituara nga vetë subjekti gjatë hetimit administrativ. Ky qëndrim, sipas Komisioneres Publike, vjen në kundërshtim me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit mbi vlerën provuese të akteve zyrtare, kontrata shitjeje, të hartuara përpara noterit publik; (iii) gjendet e pabazuar marrja në konsideratë si të ardhura të ligjshme të shumave të depozituara pranë “Raiffeisen Bank” dhe “ProCredit Bank”, sipas konfirmimeve të këtyre të fundit, depozita për të cilat, edhe pse duket se kanë qenë aktive dhe janë tërhequr gjatë periudhës deri në dhjetor 2003 (depozita pranë “ProCredit Bank”), nuk rezultojnë të jetë provuar ligjshmëria e burimit të krijimit të tyre dhe as destinacioni i përdorimit të tyre.

13.15. Rezulton se në përgjigje të barrës së provës subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se kunati i tij T.H. nuk duhet të konsiderohet *si person tjetër i lidhur*, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti me të nuk ka pasur marrëdhënie dhurimi apo huaje, duke pretenduar në këtë mënyrë që Komisioni nuk legjitimohet të kryejë një analizë financiare të burimeve të të ardhurave të tij. Nga raporti i rezultateve të hetimit paraprak, rezultojnë se analiza e detajuar financiare e Komisionit për z. T.H. është bërë jo për shkak të cilësisë si person tjetër të lidhur të subjektit, por në kuptim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, pasi është konsideruar e nevojshme të verifikohet dyshimi për një marrëdhënie të fshehur të subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri që nga viti 2003.

13.16. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e Komisioneres Publike të evidentuara më sipër, duke konsideruar se statusi i z. T.H. në këtë proces nuk është ai i personit tjetër të lidhur, sipas parashikimit në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Analiza financiare dhe kontrolli i burimeve të ligjshme të porositësit të apartamentit objekt kontrolli është kryer në kushtet kur Komisioni, por edhe Komisionerja Publike më pas kanë ngritur dyshimet mbi pronësinë e vërtetë të tij mbi këtë apartament, duke i kundërdrejtuar subjektit faktet që kanë treguar se të drejtat e tij mbi këtë pasuri nuk kanë qenë thjesht ato të përdorimit, por ato të pronarit real të pasurisë. Konkretisht, Komisioni në rezultatet e para të hetimit administrativ evidenton se analiza për z. T.H. bëhet duke vlerësuar se ka *indicie të rëndësishme në verifikim të situatës së dyshuar për fshehje pasurie*, qëndrim të cilin Komisioni e ka referuar në përputhje edhe me jurisprudencën e Kolegjit¹⁰, në të cilën organet e rivlerësimit, në zbatim të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 e 45 të ligjit nr. 84/2016, kanë të gjitha kompetencat të hetojnë e të marrin të dhëna për të gjitha faktet që janë të nevojshme për kryerjen e procesit të rivlerësimit në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë. Në këtë rast hetimi mbi pasuri të cilat dyshohet se janë fshehur prej subjektit të rivlerësimit, sigurisht që tejkalojnë kufijtë e përcaktuara për hetimin e personave të tjerë të lidhur, që i bashkëlidhen një situatë ligjore të

¹⁰ Përkatësisht vendimi nr. 21/2020 (JR) dhe vendimi nr.15/2019 (JR).

deklaruar saktësisht e të vërtetë, për të cilën nuk ngrihen dyshime të kësaj natyre. Në këtë kuptim, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se z. T.H. nuk e ka cilësinë e personit tjetër të lidhur e, për pasojë, ai nuk ka detyrimin për të provuar burimet e ligjshme të krijimit të pasurisë prej tij, nuk është relevant në situatën konkrete, pasi hetimi drejt burimeve të të ardhurave të tij nuk është zhvilluar mbështetur mbi këtë parashikim ligjor, por mbi atë të dyshimit se pasuria është e subjektit, dyshim që legjitimon hetimin dhe shtrin detyrimin mbi subjektin e rivlerësimit përtej kufijve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84.2016.

13.17. Për trajtimin sa më të plotë të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues mori në analizë të gjitha të ardhurat e identifikuara nga subjekti i rivlerësimit si burime të ardhurash të përdorura nga z. T.H. për blerjen e apartamentit në rrugën “{***}”, në Tiranë. Konstatohet se gjatë hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit, në funksion të provimit të mundësisë së kumatit të tij, z. T.H., për të financuar blerjen këtij apartamenti, ka pretenduar se duhen përfshirë të ardhurat që ai ka siguruar si bonuse/komisione gjatë ushtrimit të veprimtarisë pranë kompanive të sigurimit {***} ShA dhe {***} ShA. Për këtë qëllim, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision dy vërtetime të lëshuara nga këto kompani sigurimi. Në vërtetimin e lëshuar nga {***} ShA, me nr. {***} prot., datë 01.02.2023, rezulton se pasi përshkruhen pagat *neto* të përfituara nga z. T.H. për periudhën 2002-2020, pasqyrohet dhe se: *Gjatë kësaj periudhe z. H. ka pasur edhe të drejtën e përfitimeve nga komisionet për shitje policash. Për periudhën deri në vitin 2012, komisionet e përfituara nuk përfshiheshin në pagat mujore.* Ndërsa në vërtetimin e lëshuar nga shoqëria {***} ShA, me nr. {***} prot., datë 08.02.2023, lidhur me të ardhurat e përfituara nga z. T.H. për vitet 1995-1999, deklarohet, ndër të tjera, se: *Kërkuesi ka përfituar bonus për shitjen për çdo periudhë për të cilën e kemi të pamundur për ta përllogaritur, pasi nuk disponojmë të dhëna në arkivë.*

13.18. Komisioni, pasi është njohur me të dhënat e pasqyruara në dy vërtetimet e cituara më lart, ka arsyetuar dhe konkluduar¹¹ se krijoi bindjen se T.H. ka përfituar të ardhura shtesë nga komisionet/bonuset, si rezultat i punës së kryer në shoqëritë e sipërcituara, duke përfshirë për efekt të analizës financiare të familjes H. të ardhurat nga bonuset në shumën 1.000.000 lekë.

¹¹ Në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi lidhur me bonuset është analizuar dhe konkluduar si vijon: [...] referuar vërtetimit të lëshuar nga shoqëria {***} ShA, konfirmohet se T. H. ka përfituar të ardhura edhe nga komisione për polica sigurimi, në cilësinë e personit të marrjes në sigurim dhe se gjatë periudhës që ka qenë i punësuar në këtë kompani pagesat për komisione nuk janë përfshirë në pagë, por paguheshin si të ardhura të tatueshme në burim. Shoqëria {***} ShA ka referuar se meqenëse politika e shpërblimit të punonjësve të shitjes synonte nxitjen e tyre për rritjen e shitjeve, komisionet që përfitonin punonjësit kanë qenë të konsiderueshme dhe të krahasueshme me pagën mujore. Ndërsa nga vërtetimi i lëshuar nga shoqëria {***} ShA konfirmohet se T. H. ka përfituar bonus për shitjet për çdo periudhë që ka punuar në këtë kompani, të cilën e kanë të pamundur për ta llogaritur, pasi nuk disponojnë të dhëna në arkivë. [...] Në analizë të provave të sipërcituara, në harmoni me deklaratimet e bëra nga subjekti, si dhe nisur nga rrethana e vlerësuar se përbën “fakt të njohur botërisht”, përfitimi i komisioneve dhe/apo i bonuseve nga agjentët e punësuar në këto kompani, si rezultat i shitjes së policave të sigurimit, trupi gjykues krijoi bindjen se shtetasi T. H. ka përfituar të ardhura shtesë nga komisionet/bonuset, si rezultat i punës së kryer në shoqëritë e sipërcituara. Në kushtet kur duket se totali i të ardhurave nga paga të përfituara nga shtetasi T. H., si rezultat i punës së kryer në kompanitë e sigurimit deri në fund të vitit 2003, ka qenë në shumën prej rreth 1.900.000 lekësh (rreth 1.050.000 lekë nga shoqëria {***} ShA dhe 850.000 lekë nga shoqëria {***} ShA), si dhe nisur nga e dhëna e referuar në vërtetimin e shoqërisë {***} ShA se të ardhurat e përfituara prej komisioneve kanë qenë të krahasueshme me vlerën e pagës, Komisioni çmon se ky shtetas mund të ketë përfituar të ardhura nga bonuset dhe/apo komisionet për këtë periudhë vlerë të përafërt apo më të lartë se shuma prej 1.000.000 lekësh.

13.19. Në analizë të pretendimeve të Komisioneres Publike, lidhur me qëndrimin e mësipërm të Komisionit, trupi gjykues konstaton problematika që lidhen me provueshmërinë e këtyre të ardhurave, pasi: **(i) së pari**, rezulton se çështja e përfitimit të bonuseve është e evidentuar në shkresat/vërtetimet që lëshojnë shoqëritë e sigurimit {***} ShA dhe {***} ShA, të cilat si qëllim kryesor kanë pasur evidentimin e pagës *neto* të z. H., pra, atë të përfituar, pasi janë paguar detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, gjatë kohës që ka punuar në këto kompani. Në këto vërtetime nuk rezulton të jetë evidentuar as shifra totale e bonuseve të përfituara dhe as shpërndarja e tyre në vite, madje në një nga këto vërtetime pasqyrohet se shoqëria e sigurimit e ka të pamundur të përlllogarisë vlerën e tyre. Në këto kushte, rezulton se konkluzioni i Komisionit, për përfitimin prej z. H. të shumës prej 1.000.000 lekësh nga bonuset, mbështetet vetëm në pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe në një lexim interpretativ të përmbajtjes së këtyre dokumenteve, të cilët duket se citojnë mes rreshtave se vlera e bonuseve mund të arrihet edhe atë të pagës së përfituar prej punonjësit. Leximi i një dokumenti, që presupozohet të përmbajë të dhëna të sakta për vlerat e përfituara në këtë mënyrë, vlerësohet se tejkalon kompetencën e organeve të rivlerësimit, për të përcaktuar vlerën provuese të provave, për sa kohë që të dhënat e aluduara në një akt të tillë shndërrohen në të vërteta procedurale të provuara në proces; **(ii) së dyti**, nuk ka të dhëna bankare apo dokumente të kohës si kontratë pune apo marrëveshje, në të cilën të përcaktohet marrja e bonuseve dhe përlllogaritja e tyre dhe as nuk ka akte si, mandatpagesa apo çeqe që provojnë marrjen e këtyre bonuseve nga z. T.H.; **(iii) së treti**, në kushtet kur bonuset nuk përfshiheshin në pagë dhe as nuk ka të dhëna dhe informacion se si ato janë përfituar nga z. H., dhe në hipotezën e marrjes në konsideratë të përfitimit të tyre, mbetet e paprovuar përmbushja e detyrimeve tatimore për këtë të ardhur, në kuptim të legjislacionit të aplikueshëm për tatimin mbi të ardhurat.

13.20. Sa më sipër, trupi gjykues çmon se përfshirja në analizë e vlerës së siguruar nga z. T.H. nga bonuset, pa u bazuar në prova të kohës kur këto të ardhura janë krijuar, si dhe pa u evidentuar kjo shifër në asnjë shkresë të lëshuar nga kompanitë e sigurimit, qoftë edhe përgjatë hetimit administrativ, është një praktikë që vjen ndesh me standardet e vlerësimit të aplikuar deri aktualisht nga organet e rivlerësimit. Në drejtim të këtyre të ardhurave edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti akte dhe shpjegime të tjera të ndryshme nga ato të evidentuara më sipër.

13.21. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se pretendimi i Komisioneres Publike, lidhur me të ardhurat e pretenduara si të siguruara nga z. T.H. në formën e bonuseve nga shoqëritë e sigurimit {***} ShA dhe {***} ShA, si të paprovuara në dokumente provues të kohës kur janë krijuar, duke mbetur në nivel deklarativ, është një pretendimin i drejtë. Për këto arsye, trupi gjykues çmon se këto të ardhura, të cilat janë jo vetëm të paprovuara sa se janë përfituar, por edhe të panënshtuara pagimit të detyrimeve tatimore, nuk duhen konsideruar si të ardhura që plotësojnë standardin kushtetues e ligjor të të ardhurës së ligjshme për efekt të këtij procesi e, për pasojë, nuk duhet të përfshihen si të tilla në analizën financiare që do të kontrollojë burimet e familjes H., për financimin e çmimit të pasurisë objekt kontrolli.

13.22. Në lidhje me pretendimin e Komisioneres Publike, për të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit si të siguruara nga familja H., nga shitja e dy apartamenteve në Kukës, përkatësisht me sip. 85 m² dhe sip. 96 m², trupi gjykues konstaton dhe analizon sa vijon.

13.23. Në vendimin e Komisionit, lidhur me të ardhurat e siguruar nga kontratat e shitjes përkatësisht: **(i)** nr. {***}, datë 05.08.2002, të pasurisë “apartament banimi”, të ndodhur në qytetin e Kukësit, me sip. 85 m², për çmimin 1.000.000 lekë; dhe **(ii)** nr. {***}, datë 04.12.2003, të pasurisë “banesë njëkatëshe” me sip. 96 m² dhe truall me sip. 240 m², për çmimin 1.000.000 lekë, është arsyetuar se: *Komisioni mbështetur në sa me sipër ka krijuar bindjen se pasuritë e sipërcituara janë shitur me një çmim më të lartë nga ai i referuar në kontratat e shitblerjes së tyre dhe se, bazuar në vlerën e tregut të lirë për periudhën kur ato janë shitur, vlera totale e shitjes së tyre mund të ketë qenë mbi 5.000.000 lekë. Për Komisionin një tjetër indicie e rëndësishme, e cila ka mbështetur deklaratimet dhe aktet e depozituara referuar vlerës së shitjes së këtyre pasurive nga familja H., është transaksioni i shitblerjes së apartamentit të subjektit i rivlerësimit me Drejtorinë Rajonale të EKB-së në qytetin e Kukësit në të cilën çmimi i shitjes është përcaktuar në shumën 2.640.252 lekë.*

13.24. Qëndrimi i mësipërm i Komisionit është bazuar në shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, i cili ka pretenduar se vlera reale e shitjes së apartamentit me sipërfaqe 85 m² ka qenë rreth 2.500.000 lekë, ndërsa vlera reale e shitjes së banesës me sipërfaqe 96 m² dhe truallit prej 240 m² ka qenë 2.800.000 lekë. Subjekti i ka mbështetur këto pretendime në aktet e administruara gjatë hetimit si: **(i)** raport vlerësimi i datës 02.03.2023, për pasurinë nr. {***}, në {***}, për apartamentin me sipërfaqe 85 m² i kryer nga ekspertët e licencuar ing. B. M., ing. E. S. dhe ekonomistja E. H., në të cilin është përdorur për llogaritjen e çmimit të shitjes së kësaj pasurie çmimi mesatar i apartamenteve në tregun e lirë për qytetin e Kukësit, për sipërfaqe shfrytëzimi në vitin 2002, mbi bazën e së cilës pasuria është vlerësuar në shumën 2.464.490 lekë; **(ii)** raport vlerësimi i datës 02.03.2023, për pasurinë në {***} e përbërë nga apartament me sipërfaqe 96 m² dhe truallin me sipërfaqe 240 m², i kryer nga të njëjtët ekspertë, në të cilin është përdorur për llogaritje çmimi mesatar i apartamenteve në tregun e lirë për qytetin e Kukësit, për sipërfaqe shfrytëzimi në vitin 2003, ndërsa për vlerësimin e truallit janë përdorur çmimet e tregut të lirë, mbi bazën e të cilëve pasuria është vlerësuar në shumën 3.238.176 lekë (trualli 960.000 lekë + banesa 2.278.176 lekë); **(iii)** shkresa e Entit Kombëtar të Banesave, Drejtoria Teknike me nr. {***} prot., datë 28.02.2023, e cila informon se vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë për qytetin e Kukësit, në vitin 2002 është 28.994 lekë/m² për sipërfaqe shfrytëzimi, referuar tabelës nr. 2, miratuar me UKM-në nr. 3, datë 16.10.2002 dhe në vitin 2003 është 27.505 lekë/m² për sipërfaqe shfrytëzimi, referuar tabelës nr. 2, miratuar me UKM-në nr. 1, datë 08.05.2003; si dhe; **(iv)** deklaratën noteriale të shtetasve T.H. dhe S. D. me nr. {***} të datës 01.03.2023, të cilët kanë pranuar se si çmimi real i shitblerjes së kësaj pasurie në vitin 2003 ka qenë në vlerën 2.800.000 lekë.

13.25. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim pretendimin e Komisioneres Publike, sipas së cilit të ardhurat e përlllogaritura nga Komisioni se janë krijuar nga këto transaksione janë gati sa 2.5 herë më të larta se ato që rezultojnë të pasqyruara në kontratat respektive të shitjes, për të cilat nga analiza e të dhënave që u pasqyruan më lart, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj nuk paraqiti akte të tjera nga ato të cituara më sipër që ishin administruar gjatë hetimit administrativ në Komision, arriti në përfundimin se ky pretendim ishte i drejtë. Nga analiza e të dhënave që kanë rezultuar nga hetimi administrativ, konstatohet se shitja nga z. T.H. e pasurive apartament banimi me sip. 85 m² në Kukës dhe pasurisë “banesë njëkatëshe”, po në Kukës, me sip. 96 m² dhe truallin me sip. 240 m², sipas kontratave respektive

të shitjes së cituara më lart, është kryer për të dyja pasuritë, për një çmim të përcaktuar në kontrata prej 1.000.000 lekësh. Në këto kushte, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se z. T.H. ka siguruar vlera më të larta nga shitja e dy pasurive të paluajtshme në Kukës, respektivisht 2.464.490 lekë për apartamentin dhe 3.238.176 lekë për banesën së bashku me truallin, bazohet vetëm në raportet respektive të vlerësimit që mbajnë datën 02.03.2023, të hartuar nga ekspertë të fushës, mbi bazën e kërkesës së subjektit të rivlerësimit, mbi të dhëna të sugjeruara prej tij, për nevoja e në funksion të procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit, i cili ishte duke u zhvilluar në Komision. Gjithashtu, vlerat e evidentuara në këto akte ekspertimi¹² synojnë të orientojnë se sa këto pasuri vlenin në tregun e lirë të shitjes së pasurive të paluajtshme në kohën e kryerjes së transaksionit, por ato nuk provojnë vlerën e përfutur realisht nga shitja e këtyre dy pasurive të paluajtshme nga z. H. dhe as mund të kontestojnë e të zëvendësojnë vlerat e shitjes të këtyre dy pasurive të përcaktuara në kontratat respektive të shitjes. Në këtë drejtim, Kolegji sjell në vëmendje qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e tij të deritanishme¹³, në të cilën është mirëpërcaktuar se vlerat e kontratave (për më tepër ato të shitblerjeve të pasurive të paluajtshme) nuk mund të ndryshohen/kontestohen me akte të prodhuara përgjatë dhe në funksion të procesit të rivlerësimit kalimtar të subjekteve. Vlerat e përcaktuara në këto akte zyrtare me fuqi të plotë provuese kanë forcën e ligjit për palët dhe mund të goditen vetëm për falsitet¹⁴. Ashtu siç ka vepruar tashmë në mënyrë të qëndrueshme Kolegji në jurisprudencën e tij, edhe në këtë rast, trupi gjykues çmon se përmbajtja e kontratës noteriale do të konsiderohet si referim ligjor për sa parashikohet në të, për sa kohë që nuk ekzistojnë prova me shkresë me vlerë provuese të plotë apo të dhëna të rëndësishme që burojnë nga burime të pavarura dhe jashtë këtij procesi, që të sugjerojnë për të kundërtën. Kjo mënyrë e të konsideruarit të përmbajtjes së kontratave ka krijuar tashmë një jurisprudencë të konsoliduar, e cila vlerësohet e rëndësishme dhe përtej procesit të rivlerësimit të subjektit Naim Tota, në garantim të zbatimit të parimit të sigurisë juridike për të gjithë subjektet e rivlerësimit. Së fundmi, konstatohet se mbetet e paprovuar që vlerat e siguruara nga shitja e pasurive në Kukës të familjes H., madje edhe sipas vlerave të kontratave së shitjes, të kenë shkuar për të mbuluar blerjen e apartamentit në rrugën “{***}”, në Tiranë, pasi në atë periudhë z. H. rezulton të ketë kryer një investim tjetër të rëndësishëm, siç ndërtimi i banesës së tij në zonën e {***}, për të cilën ai ka vetëdeklaruar se ishte duke e ndërtuar në kohën e blerjes së apartamentit, gjatë marrjes së tij në pyetje në Komision, në funksion të procesit të rivlerësimit të subjektit.

13.26. Bazuar në sa evidentuar më sipër, trupi gjykues çmon se përfshirja në analizën ekonomike të familjes H. e vlerave të shitjes së pasurive në Kukës, jo në vlerat e përcaktuara në kontratat e shitjes së tyre, por sipas vlerave të pretenduara prej subjektit e të evidentuara në raportet e vlerësimit të ekspertëve të caktuar/angazhuar prej tij, bie ndesh me dokumentet ligjore dhe jurisprudencën e Kolegjit, prandaj në analizën financiare të kësaj familje do të llogariten si

¹² Kolegji evidenton se edhe në versionin që pranohet se vlerat që familja H. ka siguruar nga shitja e dy pasurive në Kukës në vitin 2002 dhe 2003 janë ato që evidentohet në aktet e vlerësimit të hartuara nga ekspertët e angazhuar nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit, në kushtet kur për këto vlera në kuptim të parashikimeve të ligjit nr. 8438/1998, nuk janë paguar detyrimet tatimore, nuk mund të pranohet se përmbushin kërkesat e nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, për t'u konsideruar si të ardhura të ligjshme.

¹³ Vendimet e Kolegjit (JR) nr. 16/2019 ; (JR) nr. 34/2019; (JR) nr. 9/2020 dhe (JR) nr. 41/2022.

¹⁴ Neni 232 të Kodit të Procedurës Civile i cili parashikon se nuk lejohet prova me dëshmitarë kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar ose privat që përbën provë të plotë; si dhe neni 690 të Kodit Civil, i cili përcakton se kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit midis palëve.

të ardhura vlerat e përfituara prej saj nga këto transaksione, sipas çmimit të përcaktuar në kontratat e shitjes së këtyre pasurive, në vlerat me nga 1.000.000 lekë secila.

13.27. Në vijim, trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimin e Komisioneres Publike se *nuk është e drejtë dhe e justifikuar ligjërisht marrja në konsideratë nga Komisioni i shumave të depozituara pranë “Raiffeisen Bank” dhe “ProCredit Bank”, sipas konfirmimeve të këtyre të fundit, depozita për të cilat edhe pse duket se kanë qenë aktive dhe janë tërhequr (depozita pranë “ProCredit Bank”), gjatë periudhës deri në dhjetor 2003, nuk rezultojn të jetë provuar ligjshmëria e burimit të krijimit dhe destinacioni i tyre.* Lidhur me këtë pretendim konstatohet se:

13.28. Nga analizimi i të dhënave të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, rezultojn se gjendja në vlera monetare, sipas dokumentacionit bankar të disponuar nga shtetasi T.H. dhe bashkëshortja e tij për periudhën para blerjes së apartamenti në Tiranë, ka qenë si vijon: (i) sipas informacionit të përcjellë nga “Raiffeisen Bank”¹⁵, rezultojn se T.H. me bashkëshorten kanë hapur në datën 12.01.2001, një llogari dyemërore pranë Bankës së Kursimeve, dega Kukës, në shumën 253.284 lekë, në të cilën janë kryer në vijim disa depozitime të tjera *cash* dhe shuma e akumuluar deri në datën 30.01.2002, në vlerën 1.595.820 lekë, është transferuar në Bankën e Kursimeve, dega Tiranë. Rezultojn se në vijim nga kjo llogari janë kryer tërheqje, respektivisht në datën 02.04.2002 në shumën 1.100.000 lekë dhe në datën 02.08.2002 në shumën 472.275 lekë. Mbas tërheqjes së shumës së mbetur në llogari prej 52.946 lekësh, kjo depozitë është mbyllur përfundimisht në datën 03.06.2003. Nga analizimi i akteve, trupi gjykues konstaton se kësti i parë është paguar në datën 03.04.2003, larg datës së tërheqjes së shumave në gusht të vitit 2002 dhe para mbylljes së llogarisë më 03.06.2003, nga e cila janë tërhequr vetëm 52.9456 lekë; (ii) referuar informacionit të përcjellë nga *Banka e Kursimeve, dega Kukës*, rezultojn se në datën 06.08.2002, shtetasi T.H. ka çelur një depozitë në shumën 1.900.000 lekë, e cila në të njëjtën ditë është transferuar në Bankën e Kursimeve, dega Tirana 1, Agjencia nr. 3. Në datën 03.06.2003 nga kjo depozitë është tërhequr shuma e akumuluar prej 2.012.462 lekësh dhe depozita është mbyllur; (iii) sipas informacionit të përcjellë nga “ProCredit Bank” me përshkrimin *lëvizje llogarie* të shtetasit T.H., konfirmohet se ky shtetas në datën 11.06.2003 ka hapur llogarinë depozitë në monedhën dollarë amerikanë (USD) dhe ka depozituar, në po të njëjtën ditë, shumën prej 20.200 USD, duke e investuar në depozitë me afat. Në vijim të verifikimit të kësaj llogarie, rezultojn se në datën 05.11.2003 është depozituar në këtë llogari shuma 3.500 USD dhe në datën 18.11.2003 shuma 1.500 USD. Këto vlera monetare të ndodhura në këtë depozitë së bashku me interesat bankare të përfituara, konkretisht në një total prej 25.273 USD, janë tërhequr në datën 22.12.2003.

13.29. Në analizë të veprimeve bankare të përshkruara më sipër, trupi gjykues konstaton se shuma prej 1.900.000 lekësh është depozituar në datën 06.08.2002 pranë Bankës së Kursimeve Kukës dhe është tërhequr nga banka në datën 03.06.2003, për t’u ridepozituar në një bankë tjetër (ProCredit Bank) më datë 11.06.2003 në monedhën USD, depozitë e cila është shtuar në vijim nga depozitimet në *cash* dhe është tërhequr përfundimisht nga banka në datën 22.12.2003 në shumën totale prej 25.273 USD. Referuar datave të transaksioneve në banka, rezultojn se kjo depozitë nuk ka shërbyer për pagesën e këstit të parë kryer më 03.04.2003 prej 25.000 USD,

¹⁵ Kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 03.03.2023, nga “Raiffeisen Bank”.

dhe as për pagesën e kështit të dytë në datën 26.06.2003 në vlerën 10.000 USD. Shuma e tërhequr prej 25.273 USD, maksimalisht mund të ketë qenë disponibël vetëm për pagesën e kështit të fundit në datën 29.12.2003 në vlerën 15.000 USD.

13.30. Në vijim të kësaj analize, trupi gjykues konstaton se Komisioni është ndalur vetëm në verifikimin e disponimit të likuiditeteve në banka nga z. T.H. dhe nuk ka kryer asnjë analizë për të përcaktuar burimin dhe ligjshmërinë e krijimit të tyre. Në kushtet kur edhe përgjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, lidhur me likuiditetet në depozitat bankare të familjes H., nuk paraqiti dokumentacion që provon burimet e krijimit dhe ligjshmërinë e tyre, kjo situatë pamundësoi përfshirjen e këtyre vlerave si burime të financimit të apartamentit në rrugën “{***}”, në Tiranë.

Për sa më sipër, për shkak të mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e fondeve të derdhura në depozitat bankare të sipërcituara, trupi gjykues, në analizën e kryer në funksion të identifikimit të mundësisë së familjes H. për të financuar me burime të ligjshme blerjen e apartamenti në rrugën “{***}”, në Tiranë, nuk ka përfshirë fondet e depozitave të sipërcituara.

13.31. Në përfundim, trupi gjykues, pasi verifikoi pretendimet e Komisioneres Publike të ngritura në drejtim të analizës financiare që Komisioni ka bërë për familjen e z. T.H., për të identifikuar burimet e ligjshme që ai ka pasur në dispozicion në momentin e blerjes së apartamentit në rrugën “{***}”, në Tiranë, arrin në konkluzionin se, duke reflektuar në analizën financiare të kryer nga Komisioni konkluzionet e mësipërme për mos përfshirjen në këtë analizë të vlerave nga bonuset/komisionet e pretenduara si të përfituara nga shoqëritë e sigurimit, si dhe duke përfshirë në analizë vlerat e shitjes së pasurive të paluajtshme të familjes H. sipas vlerave të evidentuara në kontratat e shitjes së tyre, duke mos konsideruar si burime të përdorura për blerjen e kësaj pasurie shumëmat e gjendura në depozitat bankare për shkaqet e arsyetuara më lart, rezulton se kjo familje gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të financuar këtë pasuri në vlerën prej (-) 3.388.759 lekësh.

13.32. Kjo situatë financiare, ndonëse nuk ngarkon drejtpërdrejtë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, do të vlerësohet së bashku me konkluzionet e tjera të arritura nga kontrolli i marrëdhënies së subjektit me këtë pasuri në mënyrë të harmonizuar e integrale për të pasur një qëndrim në përgjigje të pretendimit të Komisioneres Publike, lidhur me të drejtat e subjektit të rivlerësimit mbi këtë pasuri, si një pronë *de facto* e tij. Qëndrimi i marrë prej Komisionit se diligenca me të cilën kontrollohen këto burime nuk është e njëjtë me atë me të cilën kontrollohen burimet e subjekteve, për shkak të faktit se këta individë nuk janë në rrethin e personave të lidhur me subjektin, gjendet pa relevancë në rastin konkret, pikërisht për shkak të arsytimit të bërë më lart në këtë vendim, lidhur me kufijtë e hetimit në drejtim të këtyre burimeve, në kuadër të dyshimeve të ngritura prej vetë Komisionit, për pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit. Përderisa vetë Komisioni në raportin e rezultateve paraprake të hetimit ka ngritur dyshime të artikuluara qartë e të shoqëruara me barrën e provës për t’i kundërshtuar ato, niveli i kontrollit të burimeve të personave që mbajnë pasurinë *de jure* nuk mund të limitohet për shkak të ndonjë standardi ligjor, por ai vlerësohet rast pas rasti prej vetë organeve të rivlerësimit në përputhje me nevojat e rastit për hetim.

- 14.** Lidhur me pretendimin e Komisioneres Publike se *çmimi i blerjes/përfitimit nga subjekti i rivlerësimit i pasurie apartamenti në rrugën “{***}”, në Tiranë, në vitin 2016, nëpërmjet*

kontratës së cedimit, duke qenë i njëjtë me atë të blerjes nga ceduesi 12 vite më parë, kur vlera e këtij apartamenti në tregun e lirë është trefishuar është një e dhënë, e cila shton argumentet që kemi të bëjmë me një marrëdhënie të fshehur të subjektit të rivlerësimit që nga viti 2003, trupi gjykues konstaton e analizon sa vijon:

14.1. Në vendimin e Komisionit, lidhur me shumën e përcaktuar në kontratën e cedimit si vlera me të cilën subjekti i rivlerësimit ka përfituar pronësinë apartament në rrugën “{***}”, në Tiranë, është arsyetuar rreth lapsusit/gabimit të konstatuar në kontratën e cedimit të të drejtave të datës 16.03.2016, rreth ekzistencës së një marrëdhënie huaje mes subjektit dhe z. T.H., për një shumë prej 40.000 eurosh dhe ndikimit të saj në përpilimin e kontratës së cedimit dhe kushteve të saj, si edhe rreth pikëpyetjeve që kanë lindur për shkak të faktit se çmimi mbi të cilin janë ceduar të drejtat nga ceduesi, z. T.H., tek përfituesi, subjekti i rivlerësimit, ka qenë i njëjtë me atë të vitit 2003, kur është porositur kjo pasuri prej ceduesit.

14.2. Komisioni ka arsyetuar se gabimi/lapsusi në kontratën e cedimit, për mënyrën e pagimit të çmimit të saj, nga përfituesi të shoqëria ndërtimore, i cili është korrigjuar më pas nga vetë palët, me atë të një deklaratë që hartohet me qëllimin për ta saktësuar/korrigjuar atë, vlerësohet si një gabim pa peshë në vlerësimin e situatës dhe dyshimeve të ngritura në kontekstin e një pasurie të fshehur të subjektit. Për më tepër, sipas vlerësimit të Komisionit, ekzistenca e marrëdhënies së huasë mes subjektit dhe z. T.H., për një shumë prej 40.000 eurosh, e cila daton që në vitin 2008, dhe ka vijuar të ekzistojë pa interes, justifikon kalimin e të drejtave me të njëjtin çmim të fituara vite më parë. Ky element merr peshë, sipas vlerësimit të Komisionit, aq më shumë në kuadër të marrëdhënieve të posaçme familjare mes subjektit dhe z. T.H. dhe faktit që shuma e dhënë atij në huadhënie ishte në fakt një pasuri që i përkiste edhe fëmijëve të tij, sepse vinte nga pasuria trashëgimore e bashkëshortes, për pasojë administrimi i saj kishte peshën e përgjegjësisë prindërore, e cila në këtë rast u shpërblye me përfitimin e një pasurie në kushte shumë të favorshme për subjektin.

14.3. Komisionerja Publike¹⁶ në ankim, por edhe në parashtrimet gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, lidhur me vlerën me të cilën subjekti nëpërmjet kontratës së cedimit ka fituar pronësinë për apartamentin në rrugën “{***}”, në Tiranë, ka sjellë në vëmendje të trupës se në vendimin e Komisionit mungon analiza se përse në kontratën e cedimit çmimi nuk ka ndryshuar në raport me çmimet e tregut, standard të cilin nga ana tjetër subjekti kërkon të aplikohet për të ardhurat që ceduesi i të drejtave ka siguruar nga shitja e apartamentit në Kukës, duke potencuar, ndër të tjera, edhe faktin se nuk rezultoi i provuar transaksioni i kryer prej subjektit të ceduesi për likuidimin e çmimit prej 50.000 USD, në vitin 2016.

¹⁶ *Citimi i këtij pretendimi në ankim është:*

Një e dhënë tjetër që merr peshë në këtë optikë vlerësimi është dhe çmimi i blerjes nga subjekti i rivlerësimit për këtë pasuri në vitin 2016, i cili sipas kontratës së cedimit është i njëjtë me çmimin e blerjes së saj rreth 12 vite më parë, nga ana e ceduesit, sipas kontratës së sipërmarrjes, ndërkohë që vlera mesatare në tregun e lirë për zonën për këtë pasuri në vitin 2016 është rreth trefish më e lartë se çmimi i përcaktuar. Në këtë kontekst, duket e palogjikshme dhe një raport i shpërpjesëtuar, që palët në këtë marrëdhënie, me një detyrim të pashlyer mes tyre (huaja e pretenduar me interes e vitit 2008) të mos kompensoheshin apo të dakordësonin ndërshtyerjen, duke konsideruar diferencën e ndjeshme në çmim në momentin e shitjes (gati trefishi). Vlen të theksohet, gjithashtu, se nuk ka asnjë provë që shuma prej 50.000 USD të jetë transferuar/paguar nga subjekti i rivlerësimit tek z. T. H., si detyrim i kontratës së cedimit të të drejtave.

14.4. Lidhur me këto pretendime të Komisioneres Publike, trupi gjykues analizoi disa nga rrethanat e rezultuara rreth kontratës së cedimit të të drejtave me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.03.2016, nëpërmjet të cilës ceduesi, z. T.H., i kalon subjektit të rivlerësimit, përfituesit, të drejtat e fituara nëpërmjet kontratës së porosisë në vitin 2003 mbi apartamentin objekt kontrolli. *Së pari*, rezulton se me anë të kësaj kontrate, të lidhur në vitin 2016, pas 12 vitesh posedim të pandërprerë të pasurisë apartament prej subjektit të rivlerësimit dhe familjes së tij, ceduesi/porositësi i kësaj pasurie i kalon atij të drejtat e fituara prej kontratës së porosisë së vitit 2003 mbi këtë pasuri, për të njëjtin çmim të paguar prej tij në vlerën prej 50.000 USD. Nga të dhënat që referojnë te çmimet e tregut në zonën ku ndodhet kjo pasuri, rezulton se çmimi për të në kohën e përpilimit të kësaj kontrate, duhet të ishte rreth trefish më i lartë, fakt që duket se favorizon në mënyrë të paarsyeshme subjektin, ndërsa dëmton dukshëm interesat financiare të ceduesit. *Së dyti*, cedimi i kryer në këto kushte dhe me këtë çmim vjen pas një periudhe të gjatë përdorimi, pothuaj pa shpërblim, përveç vitit 2008, gjatë të cilit është deklaruar pagimi i qirasë të kësaj pasurie të financuar nga ceduesi, sipas pretendimit të subjektit, por të përdorur vetëm prej këtij të fundit në mënyrë të pashqetësuar prej pronarit ligjor të saj. *Së treti*, në kushtet kur palët deklarojnë se mes tyre ka ekzistuar një marrëdhënie huaje e deklaruar si e tillë që në vitin 2008, për një shumë prej 40.000 eurosh, e cila rezulton ende e pashlyer edhe përgjatë gjykimit në Kolegj¹⁷, ajo logjikshëm duhej të ishte konsideruar në përcaktimin e mënyrës së shlyerjes së detyrimit të subjektit për çmimin e apartamentit, duke përdorur institutin e kompensimit të detyrimeve, sipas parashikimit të neneve 514-523 të Kodit Civil. Mos përdorja e këtij instituti për të shuar dy detyrime, të cilat sipas deklarimeve i përkasin një kohe të largët dhe që pavarësisht se ekzistonin njëkohësisht në vitin 2016, e duket se kanë humbur qëllimin e tyre, sugjeron për dyshime të arsyeshme rreth mosekzistencës së tyre apo edhe pagimit në realitet të çmimit të përcaktuar në kontratën e cedimit, rrethanë që i bashkëlidhet fakteve të tjera të arsyetuara më lart, të cilat konfirmojnë panoramën e pretenduar prej Komisionerit Publik në ankim se apartamenti ka qenë gjithmonë pasuri *de facto* e subjektit të rivlerësimit.

14.5. Një element tjetër i shtruar për analizë nga ankimi i Komisionerit Publik është situata që konstatohet me ndreqjen/saktësimin e kontratës së cedimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.03.2016, lidhur me mënyrën e pagesës së çmimit të kësaj kontrate. Sipas pikës katër të kësaj kontrate, është përcaktuar se *ceduesi deklaron se pagesat e këtyre tre kësteve¹⁸ në vlerën 50.000 USD, që i ka likuiduar shoqërisë sipërmarrëse, i janë dhënë nga përfituesi*, ndërsa në pikën 6 të kësaj kontrate vijohet me përcaktimin se *përfituesi ka paguar për blerjen e të drejtave të apartamentit, sipas parashikimeve të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes*. Kjo kontratë në vijim, në nenin 2 të saj, përcakton se vlera prej 50.000 USD është likuiduar prej përfituesit te ceduesi, jashtë zyrës noteriale, pa përcaktuar kohën se kur, si dhe pa u vërtetuar nga noteri publik në ndonjë mënyrë me autoritetin e tij se këto pagesa janë bërë në kohën e lidhjes së kësaj kontrate dhe as formën e shlyerjes së tyre. Si qëllim i kontratës shpallet se është kalimi i të drejtave të fituara prej ceduesit mbi apartamentin te përfituesi, dhe duket se të gjitha elementët

¹⁷ Me parashtrimet për seancën gjyqësorë të zhvilluar në Kolegj më datë 30.11.2023, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si provë aktin deklarativ noteriale (për njohjen detyrimi ose shume në të holla) me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.11.2023, të lëshuar nga trashëgimtarët e të ndierit T. H., të cilët konfirmojnë huamarrjen e trashëgimlënësins të tyre ndaj subjektit të rivlerësimit Naim Tota dhe deklarojnë se marrin përsipër shlyerjen e huas me dy këste sipas deklaramit.

¹⁸ Çmimi i kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., datë 03.04.2003, është paguar në cash nga z. T. H., pranë kompanisë së ndërtimit me anë të mandatpagesave të datave 03.04.2003; 26.06.2003 dhe 29.12.2003.

e tjerë të kësaj marrëdhënie janë rregulluar në një kohë të ndryshme nga koha e lidhjes së saj. Duke interpretuar përmbajtjen e kësaj kontrate, sipas rregullave të parashikuara në nenit 659 e vijues të Kodit Civil, Kolegji vëren se është i drejtë konstatimi i Komisioneres Publike se përmbajtja e saj sugjeron që në leximin e përcaktimeve për pagimin e çmimit, në drejtim të faktit se ai është paguar nga përfituesi, subjekti i rivlerësimit, tek shoqëria sipërmarrëse, sipas përcaktimeve të kontratës së sipërmarrjes dhe se ceduesi, z. T.H., ka bërë vetëm dorëzimin fizik të shumave të dhëna atij prej përfituesit.

14.6. Kjo situatë duket se potencohet në drejtim të besueshmërisë edhe nga deklarata noteriale që titullohet “Saktësim kontrate” me nr. {***}rep., nr. {***} kol., datë 07.06.2016, në të cilën palët, cedues dhe përfitues, bien dakord që shprehja e përdorur në pikën e katërt të kontratës së cedimit është e shkruar gabim dhe se shprehja *i janë dhënë nga përfituesi* duhet hequr, duke qenë se sipas tyre, në të kundërt, paratë janë paguar prej ceduesit te sipërmarrësi. Ky saktësim në vlerësimin e trupit gjykues tregon se edhe vetë palët në kontratë e kanë lexuar përmbajtjen e pikës katër të kontratës, ashtu siç e lexon edhe Komisionerja Publike, lexim i cili i jep kuptim të shtuar të gjithë dyshimit të ngritur se pasuria apartament është blerë dhe financuar që në fillimet e krijimit të saj prej subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues, pas kësaj analize, arriti në konkluzionin se ky element, gjithashtu, është një indicie, i cili duhet të vlerësohet në harmoni me të gjitha të dhënat e tjera që kanë rezultuar nga analiza e kësaj shtate, në drejtim të analizimit të shkakut të ankimit të Komisionerit Publik.

14.7. Në vijim të analizës, trupi gjykues, gjithashtu, konstaton se në kuptim të përcaktimit të modaliteteve të realizimit të transaksionit të shitjes së pasurive të paluajtshme, me kontratën e cedimit të të drejtave të datës 16.03.2016, në kushtet kur kjo kontratë specifikon se çmimi është paguar jashtë kësaj zyre noteriale, mungon të jetë bërë prej Komisionit një analizë, përse në këtë rast nuk ka gjetur aplikim udhëzimi i përbashkët nr. {***}, datë 30.01.2012¹⁹, i lidhur midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave për modalitetet e pagesave në rastet e transaksioneve të shitjeve të pasurive të paluajtshme nëpërmjet llogarisë bankare të noterit, analizë e cila, gjithashtu, do të evidentonte dhe peshonte mungesën e pagesës nëpërmjet transaksionit bankar të çmimit në vitin 2016, aq më tepër në kushtet kur kuadri ligjor në fuqi e përcaktonte si të detyrueshëm atë, si një element që shkon, po ashtu, drejt mbështetjes së dyshimit se subjekti ka paguar për blerjen e kësaj pasurie që në vitin 2003.

- 15.** Brenda shkakut të ankimit që lidhet me marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri, Komisioneri Publik ka ngritur edhe çështjen që lidhet me *paqartësinë në ekzistencën e marrëdhënies se huadhënies që subjekti ka pasur në vitin 2008 me z. T.H., si dhe zbatimin e saj*. Analiza e kësaj marrëdhënieje zhvillohet në kontekstin e analizimit të të gjithë elementëve, që në një mënyrë apo tjetër janë të lidhura me marrëdhënien e subjektit me pasurinë apartament dhe për të mbështetur dhe potencuar dyshimet e ngritura në këtë drejtim.

15.1. Rezulton se në DVP-në e vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *huadhënie me interes shuma 40.000 euro. Të ardhura nga interesat e huadhënies 3.000 euro*. Në këtë deklaram

¹⁹ Udhëzimin nr. 6915/2, datë 30.01.2020, tek i cili ndryshohet udhëzimi fillestar nr. 6915/2, i datës 30.01.2012: <https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2020/09/Udhëzimi-i-Perbashket-Md-dhe-MFE-nr.-20-date-14.09.2020-%E2%80%9CP%C3%ABr-Procedur%C3%ABn-teknike-p%C3%ABr-krverjen-e-pages%C3%ABs-n%C3%AB-rastet-e-kalimit-t%C3%AB-pasurive-t%C3%AB-paluajtshme%E2%80%9D.pdf>

subjekti nuk ka përcaktuar/identifikuar, siç kërkon ligji nr. 9049/2003 dhe ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, individin apo personin fizik apo juridik, të cilit i ka dhënë hua me interes shumë 40.000 euro dhe as ka evidentuar një kontratë nëpërmjet së cilës është dhënë hua kjo shumë. Nga deklarimi i bërë në DVP-në e vitit 2008 dhe të vitit 2009, konstatohet se huadhënia e shumës 40.000 euro është bërë me një interes që i siguron subjektit të ardhura 600 euro në muaj.

15.2. Në DVP-në e vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *gjendje cash nga interesat e huas (8 muaj x 600 euro)*, në total 4.800 euro. Nga kjo deklaratë e deri në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi më interesa që burojnë nga kjo marrëdhënie huaje. Në deklaratën *vetting*, në kuadër të deklaratimeve për krijimin e të ardhurës prej 40.000 eurosh të krijuar prej shitjes së aksioneve të bashkëshortes në shoqërinë {***} ShA, subjekti ka deklaruar se kjo shumë i është dhënë në huapërdorje me interes 1.5 % në muaj z. T.H., duke paraqitur edhe aktet bashkëlidhur²⁰.

15.3. Në analizë të fakteve të përmendura më sipër, rezulton se subjekti vetëm në deklaratën *vetting* ka deklaruar se huanë ia ka dhënë me interes kumatit të tij, z. T.H., në apartamentin e të cilit jetonte pa shpërblim që nga viti 2004, si dhe ka dorëzuar deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.03.2009, me të cilën ka nisur marrëdhënien e huadhënies. Në këtë deklaratë noteriale, deklaruesi Naim Tota deklaroi se i ka dhënë z. T.H. shumë prej 40.000 eurosh, e cila do të kthehet në një afat të pacaktuar kundrejt një interesi mujor prej 1.5 % (600 euro). Në rast të mospagimit të interesit mujor, kjo shumë do të kthehet menjëherë. Trupi gjykues konstaton *së pari*, se në mënyrë të paarsyeshme, në këtë akt shfaqet si deklarues subjekti i rivlerësimit, deklarim i cili nuk do të mund të prodhonte asnjë pasojë ligjore ndaj huamarrësit, për sa kohë ai nuk konfirmon para noteres marrjen e kësaj shume hua. Nënshkrimi i z. H. në këtë akt shfaqet jashtë formatit të deklaratës, e shkruar me shkrim dore dhe nënshkrimin, jashtë tekstit të redaktuar prej noteres, rrethanë që nuk konfirmon faktin që huamarrësi të ketë qenë prezent dhe të ketë pohuar marrjen përsipër të detyrimit, si dhe shlyerjes së tij. Hartimi i këtij akti pamundëson konsiderimin e tij si titull ekzekutiv, sipas parashikimeve të nenit 510, paragrafi 2, shkronja “d” e Kodit Procedurës Civile dhe në këtë kontekst, duket i pakuptimtë edhe vetë përpilimi dhe qëllimi për hartimin e tij, përveç se për efekt të mbështetjes së deklaratimeve periodike, të cilin nuk e realizon pavarësisht, për shkak të defekteve në formën e hartimit të tij.

15.4. Përveç sa më sipër, trupi gjykues sjell në vëmendje se subjekti ka kundërthënë e mungesë koherence në drejtim të kësaj marrëdhënieje, përtej faktit se ai nuk ka deklaruar asnjëherë huamarrësin e saj, në deklaratat periodike dhe e ka deklaruar atë vetëm në deklaratën *vetting*. Gjithashtu, subjekti ka mungesë konsistence në drejtim të përfitimit të interesit prej kësaj marrëdhënie. Ndërsa në deklaratën noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.03.2009, deklarohet se do të përfitohet interes në masën 1.5 % në muaj dhe në DVP-të për vitet 2008 e 2009 deklarohet se ky interes është përfituar si i tillë pa asnjë shpjegim në deklaratimet në DVP-të vijuese, përfitimi i këtij interesi ndërpritet. Krahas kësaj situatë, sërish në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit, ndërsa identifikon për herë të parë huadhënësin, deklaroi se huaja është

²⁰ Vërtetimin nr. {***} prot., datë 09.01.2017 dhe deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.03.2009.

dhënë me interes në të njëjtën vlerë të deklaruar në vitin 2008, ndërsa gjatë procesit hetimor dhe atij gjyqësor ka mbajtur qëndrimin se ky interes nuk është përfituar për shkak të përdorimit të apartamentit, i cili është përdorur me qira vetëm për një vit dhe pastaj pa kundërshtpërblim. Në vlerësimin e trupës gjyqësore, shpjegimet e subjektit duken të paarsyeshme dhe jobindëse, për sa kohë që i nuk i japin përgjigje pyetjes, se përse subjekti i rivlerësimit në vitin 2008 i jep hua shumë prej 40.000 eurosh me një interes të lartë vjetor prej 18%, z. T.H., kunatit të tij, ndërsa ky i fundit i kishte lënë për banim pa shpërblim apartamentin e blerë prej tij, që në vitin 2004, për të dhe familjen e tij, për shkak të marrëdhënieve familjare të posaçme. Për sa më sipër, mbetet pa përgjigje të arsyeshme pyetja përse këto marrëdhënie familjare, që përcaktuan marrëdhënien e përdorimit pa shpërblim të apartamentit, nuk u bënë përcaktuese edhe për dhënien e huasë me interes në vitin 2008, katër vite pasi përdorimi i apartamentit kryhej pa shpërblim. Në këto kushte, trupi gjyqësor konkludon se të gjitha elementët e analizuar më sipër, të kushtëzuara nga qëndrimet kontradiktore e jo koherente të subjektit të rivlerësimit, e bëjnë të pamundur marrjen e një qëndrimi definitiv për ekzistencën e kontratës së huasë dhe kushtet e saj, elemente që shtohen në faktet e analizuar në kuadër të dyshimeve për pasuri të fshehur të subjektit, ashtu siç ka pretenduar Komisionerja Publike.

16. Trupi gjyqësor, në përfundim të analizës së kryer më lart, për pasurinë apartament banimi 2+1, të ndodhur në rrugën “{***}”, në Tiranë, duke konsideruar të gjitha faktet në harmoni dhe në mënyrë integrale në raport me njëri-tjetrin, pasi shqyrtoi shkakun e ankimit të ngritur prej Komisioneres Publike se subjekti i rivlerësimit ka qenë pronari *de facto* i kësaj pasurie që nga viti 2004 dhe ka formalizuar/legalizuar marrëdhënien me të vetëm në vitin 2016, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, e gjeti të drejtë këtë pretendim, për sa i përket konstatimit të situatës faktike.

16.1. Trupi gjyqësor i gjeti si të rëndësishme dhe përcaktuese për të konfirmuar këtë pretendim faktet si vijojnë: **(i)** subjekti i rivlerësimit ka qenë përdoruesi/poseduesi i parë dhe i vetëm i kësaj pasurie që në momentin e krijimit të saj në vitin 2004, ndërsa porositësi dhe paguesi i pretenduar i çmimit të tij, i ndjeri, z. T.H., nuk e ka përdorur atë asnjëherë; **(ii)** subjekti, ndonëse është sjellë me këtë pasuri si pronar i saj, duke gëzuar e zotëruar atë për një periudhë kohore 12-vjeçare, nuk ka deklaruar asgjë rreth kësaj marrëdhënieje dhe të drejtave reale që ai ka pasur mbi të, në deklaratat periodike të viteve 2004-2016, përveç si adresë banimi, duke shmangur në këtë mënyrë kontrollin nga institucioni i ILDKPKI-së mbi natyrën dhe ligjshmërinë e këtyre të drejtave; **(iii)** fakti që porositësi formal, z. T.H., megjithëse ka paguar çmimin për financimin e saj në vlerën 50.000 USD në vitin 2003, nuk e ka përdorur atë si banesë në të njëjtën kohë, kur ai nuk kishte zgjidhur ende problemin e banimit për familjen e tij në qytetin e Tiranës, për sa kohë që jetonte me qira dhe ndërtonte një shtëpi për të plotësuar këto nevoja; **(iv)** mungesa e burimeve të ligjshme të porositësit për të krijuar shumë prej 50.000 USD, të paguar për financimin e këtij apartamenti, e cila rezultoi pas një analize për të ardhurat e shpenzimet e familjes H., referuar në standardin kushtetues e ligjor të së ardhurës së ligjshme; **(v)** krijimi i një marrëdhënieje huaje për një shumë prej 40.000 eurosh mes subjektit dhe z. H., me interes mujor të deklaruar prej subjektit në masën prej 1.5%, në një kohë që sipas pretendimit të subjektit ai përdorte, pikërisht për shkak të një marrëdhënieje të posaçme familjare, pronën e huamarrësit pa asnjë shpërblim; **(vi)** lidhja e kontratës së cedimit të të drejtave në vitin 2016, për të njëjtin çmim të kontraktuar për porositjen e saj që në vitin 2003, ndërsa çmimet për atë

pasuri ishin rritur ndjeshëm, referuar tregut të shitblerjes së tyre; **(vii)** mungesa në kontratën e cedimit të të drejtave, e lidhur mes ceduesit/huamarrës, z. H. dhe përfituesit/huadhënës, subjektit të rivlerësimit, të pagimit të çmimit me anë të kompensimit të detyrimit që ceduesi i kishte përfituesit, për shkak të moskthimit ende të huasë së dhënë, megjithëse në aktin që dokumenton huanë, deklarohet se mospagimi i interesit është një shkak për kthimin e menjëhershëm të huasë, dhe vetë subjekti pretendon se ky interes nuk është paguar më që prej vitit 2010; **(viii)** deklarimi në kontratën e cedimit të të drejtave se pagesat e tri kësteve në vlerë totale prej 50.000 USD, që ceduesi i ka likuiduar shoqërisë sipërmarrëse i janë dhënë prej përfituesit, dhe nevojën e palëve për të saktësuar më pas me aktin *saktësim kontrate* këtë deklarim, që tregon se ai është lexuar dhe kuptuar edhe prej tyre, njësoj siç e lexon Komisionerja Publike në ankimin e tij, në funksion të provueshmërisë së faktit se çmimi është paguar që në momentin fillestar prej vetë subjektit të rivlerësimit.

16.2. Mbështetur në sa më sipër, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka qenë pronari *de facto* i kësaj pasurie që në krijimin e saj në vitin 2004 dhe, si i tillë, ai ka paguar edhe detyrimet respektive për çmimin e porositjes së saj në vlerën prej 50.000 USD, që në vitin 2003. Referuar deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike, rezulton se ai e ka fshehur ekzistencën e të drejtave të tij mbi këtë pasuri nga kontrolli i organeve kompetente për gjatë të gjithë viteve të deklarimit, duke qenë se ai ishte në pamundësi financiare ta justifikonte atë me burime të ligjshme që në momentin e krijimit të saj. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, lidhur me marrëdhënien e tij me këtë pasuri, si të përfituar nëpërmjet kontratës së cedimit të të drejtave në vitin 2016, vlerësohen në këtë kontekst si të pavërteta, qoftë për mënyrën e fitimit të pronësisë, kohën e lindjes së kësaj marrëdhënieje dhe pagesës së çmimit për të. Trupi gjykues çmoi se situata faktike e pretenduar prej Komisioneres Publike, lidhur me marrëdhënien e subjektit me këtë pasuri dhe e konfirmuar edhe prej analizës së bërë në këtë vendim, duket të kualifikohet në një parashikim të ndryshëm ligjor, duke qenë se konsiderimi i saj si një pasuri e fshehur rezulton të jetë jo i saktë, në kushtet kur subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting* të drejtat e pronësisë që ai gëzon në këtë pasuri, si dhe e ka vendosur atë në dispozicion të kontrollit të organeve të rivlerësimit. Për pasojë, në vlerësimin e trupit gjykues nuk do të gjente vend zbatimi i nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, e cila do të kualifikonte situatën në të cilën në deklaratën *vetting* subjekti do të kishte heshtur për ekzistencën e marrëdhënies së tij me këtë pasuri, duke synuar shmangien e kontrollit të organeve të rivlerësimit për të. Pavarësisht këtij konkluzioni, duke qenë se situata e paligjshmërisë rreth deklarimeve të subjektit të rivlerësimit qëndron, siç u arsyetua më lart, trupi gjykues, duke përdorur të drejtën e tij për të kualifikuar saktë faktet, sipas përcaktimit të nenit 16 të Kodit të Procedurës Civile, vlerëson se ato duhen konsideruar si të pavërteta e të rreme me synim deformimin e rezultateve të kontrollit që do ushtrohet mbi këtë pasuri prej organeve të rivlerësimit në drejtim të burimeve për krijimin e saj, të cilat rezultojnë se kanë munguar në kohën e krijimit të pasurisë, në vitin 2003.

16.3. Gjendur në këto kushte, trupi gjykues, duke konsideruar faktin që subjekti ka deklaruar rreth marrëdhënies së tij të pronësisë në deklaratën e pasurisë *vetting*, objekt kontrolli në këtë proces, të dhënat rreth pasurisë dhe mënyrës së fitimit, të cilat nuk rezultojnë t’i përgjigjen realitetit, sipas të gjithë analizës së bërë rreth fakteve të rezultuara nga hetimi e të përmendura më lart, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të rremë në këtë

deklaratë për këtë pasuri, duke u gjendur në situatën që kualifikohet sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016.

17. Kolegji mori në shqyrtim pretendimet e Komisioneres Publike, *lidhur me të ardhurat e ligjshme të subjektit të rivlerësimit, të përdorura për blerjen e aksioneve në fund të vitit 2005, nga bashkëshortja e tij e ndjerë në shoqërinë {***} ShA, nga shitja e të cilave ai ka përfituar shumën prej 40.000 eurosh, të deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting.*

17.1. Pretendimet e Komisioneres Publike, të cilat u morën në shqyrtim nga trupi gjykues, renditen si vijon: (i) *subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshortja nuk kanë deklaruar në deklaratat periodike vjetore blerjen e aksioneve të shoqërisë {***} ShA; (ii) gjithashtu, subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën vetting burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e fondit të përdorur për investimin në aksione në vitin 2005, duke mos deklaruar as në DVP dhe as në deklaratën vetting se motra e subjektit (M. D.) dhe motra e bashkëshortes së tij (R. M.) janë huadhënëse të bashkëshortes, duke dhënë deklarime kontradiktore lidhur me to në disa shpjegime të tij; (iii) subjekti i rivlerësimit, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk mundi të provojë se personat e tjerë të lidhur, kishin burime të ligjshme për të krijuar fondet e dhëna hua bashkëshortes së subjektit, të cilat janë përdorur prej saj për blerjen e aksioneve në shoqërinë {***} ShA Kosovë.*

17.2. Komisioni, pasi ka verifikuar burimin e krijimit të të ardhurave të përdorura për blerjen e aksioneve nga ish-bashkëshortja e subjektit në vitin 2005, në shumën prej 12.500 eurosh dhe pasi ka verifikuar bazuar në deklaratimet e subjektit dhe dokumentacionin e dorëzuar prej tij për të ardhurat e personave të tjerë të lidhur, ka arritur në konkluzionin se këto burime kanë qenë të ligjshme. Mungesën e deklarimeve në DVP dhe në deklaratën *vetting* të burimeve të përdorura për krijimin e kësaj pasurie, aksionet te shoqëria {***} ShA, Komisioni e ka konsideruar si një pasaktësi në deklaratimet periodike, e cila nuk duhet të ketë peshë në procesin e rivlerësimit të subjektit, sipas edhe qëndrimit të mbajtur prej Kolegjit në jurisprudencën e tij, por edhe në këndvështrim të faktit se personi që ka krijuar këtë pasuri, ish-bashkëshortja e subjektit, nuk jeton më.

17.3. Subjekti i rivlerësimit në gjykimin e çështjes në Kolegji ka prapësuar se personat e tjerë të lidhur kanë pasur burime të ligjshme për të financuar huanë e dhënë të ndjerës bashkëshortes së tij dhe se ai ka paraqitur provat shkresore që provojnë ekzistencën e këtyre burimeve. Lidhur me mosdeklarimin e huave në deklaratat periodike, subjekti është mbrojtur duke thënë se ai nuk ka pasur dijeni rreth tyre, për shkak se bashkëshortja nuk ja ka treguar.

17.4. Në shqyrtim të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues *së pari*, vëren se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting* se ai ka përfituar shumën prej 40.000 eurosh në vitin 2008, si të ardhura nga shitja e aksioneve të blera prej të ndjerës bashkëshortes së tij në shoqërinë {***} ShA, në të cilën ajo punonte në vitin 2005. Në verifikim të ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, të cilat më tej janë deklaruar se janë dhënë hua te z. T.H., siç është analizuar më sipër, Komisioni ka hetuar rreth burimeve financiare të përdorura për blerjen e këtyre aksioneve nga shitja e të cilave kanë buruar këto fonde.

17.5. Konstatimi i parë i bërë lidhur me këtë çështje, përkundrajt faktit se aksionet e shoqërisë janë blerë në datën 15.12.2005, prej bashkëshortes së ndjerë të subjektit, rezulton të jetë

mungesa e deklarimeve për krijimin e kësaj pasurie në DVP-në e vitit 2005, në të cilën subjekti dhe personi i lidhur kishin detyrimin të deklaronin krijimin e tyre, sipas përcaktimeve të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003. Për herë të parë, subjekti ka deklaruar rreth kësaj pasurie në DVP-në e vitit 2007, duke shpjeguar se *depozituar nga bashkëshortja në dhjetor të vitit 2005, në shumën prej 12.500 eurosh, me shënimin vënë në dijeni në vitin 2007 nga kompania, pas vdekjes së bashkëshortes. Një pjesë e vlerës është marrë nga bashkëshortja prej motrës së saj.* Në këtë deklaratë, subjekti ka deklaruar, gjithashtu, edhe krijimin e depozitës në Bankën Popullore në vlerën prej 44.463 eurosh, që vjen nga shitja e aksioneve të shoqërisë {***} ShA, fakt që duket se ka përcaktuar edhe nevojën për deklarimin e blerjes së aksioneve, pavarësisht se dy vjet pasi kishte lindur ky detyrim. Në DVP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar në rubrikën e detyrimeve financiare ndaj personave fizikë e juridikë se *detyrimi i mbetur ndaj motrës nga huamarrja e marrë nga bashkëshortja, F. T., që në vitin 2005, në shumën 1.000.000 lekë, nga e cila, pas vdekjes së saj, motra më fali 400.000 lekë dhe nga ana ime është shlyer deri tani 200.000 lekë, në vitin 2006. Pjesa e mbetur në shumën prej 400.000 lekësh vazhdon të mbetet detyrim pa interes dhe pa afat²¹.* Më pas, në deklaratën *vetting*, subjekti, ndërsa ka deklaruar se burimi për krijimin e shumës prej 40.000 eurosh është investimi në vlerën prej 12.500 eurosh në vitin 2005 për blerjen e aksioneve të shoqërisë {***} ShA, nuk ka deklaruar edhe në këtë deklaratë burimin e krijimit të shumës prej 12.500 eurosh. Deklarime rreth burimit të kësaj shume gjenden në shpjegimet që ka dhënë subjekti i rivlerësimit përgjatë pyetjeve në ILDKPKI dhe përgjatë hetimit administrativ në Komision, në të cilat sërish ai paraqet minimalisht konfuzion, paqartësi e pasaktësi, por edhe kontradiktoritet për elementë të caktuar.

17.6. Për sa më sipër, rezulton se subjekti, pasi është pyetur nga ILDKPKI-ja, sipas një akti, i cili duket se është depozituar në këtë institucion në datën 20.11.2008, ka deklaruar se: *“Detyrimi i mbetur ndaj motrës nga huamarrja e marrë nga bashkëshortja F. T. që në vitin 2005 në shumën 1.000.000 lekë nga e cila pas vdekjes më fali 400.000 lekë dhe nga ana ime është shlyer deri tani 200.000 lekë në vitin 2006. Pjesa e mbetur nga shuma 400.000 lekë vazhdon të mbetet detyrim pa interes dhe pa afat”.* Më tej, gjatë hetimit administrativ të kryer në Komision, subjekti për këtë investim të kryer nga bashkëshortja e ndjerë ka dhënë të njëjtin informacion me atë të dhënë në ILDKPKI më datë 20.11.2008, lidhur me burimin e krijimit të shumës prej 12.500 eurosh të përdorur për blerjen e aksioneve në datën 15.12.2005.

17.7. Nga analiza e deklarimeve të subjektit, lidhur me burimin e krijimit të aksioneve të blera te kjo shoqëri, përveç faktit se ato nuk janë deklaruar për dy vite rresht që nga momenti i krijimit dhe më pas, rezulton se janë deklaruar me vonë, në DVP-në e vitit 2007, deklarim i cili duket i kushtëzuar nga fakti që aksionet tashmë ishin shitur për një vlerë prej 44.000 eurosh dhe kjo vlerë ishte depozituar në Bankën Popullore, fakt që passillte detyrimisht shpjegimin mbi krijimin e tyre. Pavarësisht deklarimit në këtë vit, subjekti nuk ka bërë në këtë DVP një deklarim të qartë për burimin e krijimit të tyre, duke deklaruar se bashkëshortja kishte marrë një pjesë të shumës së financimit të tyre, motrës së saj dhe se këtë fakt subjekti e ka mësuar pas vdekjes së saj, duke ngritur pretendimin, të cilin e potencoi edhe në gjykimin në Kolegj, se ai ka qenë në padijeni të këtij investimi të kryer prej bashkëshortes së tij dhe se madje ajo e dinte se ai nuk ishte dakord me investime të kësaj natyre. Megjithëse ka bërë këtë deklarim, subjekti në këtë

²¹ Duket se një pjesë e deklarimeve të bërë lidhur me vlerën e aksioneve, burimin e krijimit dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e tyre, janë bërë me shtesë deklarimi të DVP 2007, në datën 20.11.2008.

deklaratë nuk ka deklaruar asgjë rreth shumës së investuar nëpërmjet huamarrjes nga motra e bashkëshortes dhe as emrin e saj.

17.8. Në të njëjtën deklaratë, sipas shënimeve të kryera përtej afatit kohor maksimal të përcaktuar nga ligji për kryerjen e deklarimit, në datën 20.11.2008, subjekti ka deklaruar se shuma prej 1.000.000 lekësh është marrë hua prej motrës për të financuar blerjen e aksioneve dhe ka përcaktuar edhe shumat e mbetura pa shlyer si detyrim. Në këto shënime, subjekti nuk ka përcaktuar se cilës motër i janë marrë këto para (nëse motra është e tij apo e bashkëshortes) dhe vetëm në një lexim harmonik të këtyre deklarimeve në raport me ato të bëra në ILDKPKI në datën 20.11.2008, mund të përcaktohet se në këtë rast si huadhënëse shfaqet motra e subjektit M. D., deklarim i cili sërish është i paplotë duke qenë se në DVP-në 2008 subjekti nuk ka deklaruar për vlerën tjetër që ka shkuar për krijimin e fondit në shumën 12.500 euro (në masën 400.000 lekë) - të cilën subjekti përgjatë hetimit administrativ ka deklaruar se i është marrë hua motrës së bashkëshortes R. M..

17.9. Përfundimisht, në analizë të fakteve të mësipërme, duke i dhënë përgjigje pretendimeve të Komisioneres Publike, lidhur me burimet e krijimit të shumës prej 12.500 eurosh të përdorur për të blerë aksionet në shoqërinë e sigurimit privat {***} Sh.A, trupi gjykues vëren se gjendet para situatës në të cilën konstaton: **(i)** mungesën e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit për krijimin e kësaj pasurie në deklaratat periodike të viteve 2005 e 2006; **(ii)** deklarime të bëra në DVP-në e vitit 2007 në mënyrë të pjesshme e të paplotë, duke krijuar paqartësi për burimin e krijimit të shumës së përdorur për blerjen e aksioneve në vlerën 12.500 euro, konstatime që do të ndikojnë/afektojnë në analizën e kryer për personat e tjerë të lidhur në zbatim të kërkesave të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

17.10. Pavarësisht paqartësisë dhe mungesës së koherencës në deklaratat e mësipërme të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimin e Komisioneres Publike, lidhur me verifikimin e mundësisë financiare të huadhënëses R. M., për të krijuar me burime të ligjshme deri në datën 15.12.2005 shumën prej 400.000 lekësh, të cilën subjekti ka deklaruar se ia ka dhënë hua bashkëshortes së tij, në kuptim të kërkesave të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

17.11. Komisioni në vendim, lidhur me këtë hua, pasi ka kontrolluar burimet e krijimit të shumës 400.000 lekë nga familja M., mbështetur në deklaratat e subjektit dhe dokumentacionin e depozituar prej tij, ka konkluduar se kanë qenë bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për shpenzimet e jetesës së kësaj familjeje në vlera të ulta dhe modeste. Gjithashtu, Komisioni ka konsideruar të provuar edhe faktin se marrja e dy kredive konsumatore prej kësaj familjeje ka shkuar për të mbuluar huanë e dhënë bashkëshortes së ndjerë të subjektit e duke pasur në konsideratë këto të dhëna ka arritur në përfundimin se kjo familje kishte të ardhura të ligjshme për të financuar dhënien hua të shumës prej 400.000 lekësh.

17.12. Subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë pretendim, gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, ashtu si edhe në Komision, ka kërkuar të konsiderohet se fakti që kunata e tij ka jetuar në fshat (në zonën e Lushnjës) ka bërë që shpenzimet e jetesës të jetë të ulta dhe të jenë mbuluar nga prodhimet bujqësore që ata kanë prodhuar në fshat. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se kunata dhe bashkëshorti kanë pasur të ardhurat nga pagat si arsimtare. Në funksion të analizës

financiare, gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se nga komunikimi që ka pasur me kumatën ajo i ka pohuar se si burim kryesor për dhënien e huas bashkëshortes së ndjerë të subjektit kanë shërbyer dy kreditë e marra në muajin dhjetor 2005. Sipas pretendimeve të subjektit, vetë fakti i marrjes së këtyre dy kredive në momentin e kryerjes së investimit për blerje aksionesh nga bashkëshortja e tij, tregon qartë se ato kanë shërbyer për këtë qëllim. Për më tepër, parashtron se provohet se ai ka shlyer së paku një këst kredie, dokumentuar kjo me provën²² e depozituar në Komision, fakt i cili tregon njohjen prej tij të kësaj huaje të marrë nga bashkëshortja.

17.13. Nga aktet e dosjes, rezulton se gjatë hetimit administrativ në Komision, në mbështetje të deklaratimeve të përshkruara më sipër, subjekti ka paraqitur me cilësinë e provës aktet: **(i)** deklaratën noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.11.2022, në të cilën huadhënësja R. M. ka deklaruar se *i kam dhënë hua motrës sime të ndjerë F. T. në vitin 2005 shumën prej 400.000 lekësh. Këtë shumë të hollash e kam pasur nga kursimet e mia familjare e punësuar si mësuese në shkollën jopublike “{***}”, në qytetin e Lushnjës, si dhe nga punësimi i bashkëshortit tim si mësues [...];* **(ii)** dokumentacion mbi të ardhurat e përfituara nga punësimi për shtetasit, R. (R.) M. dhe bashkëshorti i saj S. S. përkatësisht: **(a)** vërtetim për bazën e vlerësuar nga ISSh-ja për vitet 1997 – 2000; 2001 – 2004 dhe 2005 – 2008, për shtetasen R. (R.) M.; **(b)** vërtetim për bazën e vlerësuar nga ISSh-ja, për vitet 1998 – 2000; 2002 – 2003 dhe 2004 – 2006, për shtetasin S. S.; **(iii)** nëpërmjet shpjegimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ në Komision, për këtë çështje, ai ka deklaruar se pas kontakteve që ka bërë me kumatën ajo i ka pohuar se burimi kryesor për dhënien e huasë kanë qenë dy kreditë e marra prej tyre në dhjetor të vitit 2005, kjo pas kërkesës së bashkëshortes së tij të ndjerë, duke depozituar në mbështetje të këtij pretendimi: shkresën kthim përgjigje me nr. {***} prot., datë 02.02.2023, e “Raiffeisen Bank”, në të cilën konfirmohet për marrjen nga bashkëshorti i kumatës S. S., të kredisë prej 200.000 lekësh më datë 06.12.2005 dhe të një kredie tjetër po prej 200.000 lekësh në datën 28.12.2005, si dhe jepet informacion se: *Nga të dhënat lidhur me pagesat e kësteve të kredive, rezulton se në datën 25.07.2006 është kryer derdhja e një kësti kredie nga z. Naim Tota në shumën 20.000 lekë.*

17.14. Trupi gjykues, në funksion të shqyrtimit të pretendimit të Komisioneres Publike, kontrolloi analizën financiare për familjen M., e cila iu nënshtrua metodologjisë së përdorur në Kolegj për kontrollin e burimeve të ligjshme për personat e tjerë të lidhur, sipas përcaktimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, trupi gjykues mbajti në konsideratë faktin se pretendimi i subjektit për përdorimin e produkteve bujqësore apo të ardhurat nga shitja e këtyre produkteve prej familjes M., si një element që ul shpenzimet e jetesës së tyre, mbeti në nivel deklarativ dhe, si i tillë, ai nuk mund të ndikojë në përmirësimin e analizës financiare të kësaj familje. Për më tepër, trupi gjykues thekson se edhe në këtë rast, ashtu siç ka vepruar në çështjet e shqyrtuara deri aktualisht, janë aplikuar shpenzimet e jetesës, sipas shkresës nr. {***} prot., datë 04.03.2019, të përcjellë në Kolegj nga ILDKPKI-ja, që referon të dhënat e përcjella nga INSTAT, të cilat në tërësi parashikojnë nivele minimale shpenzimesh për kosto jetese.

17.15. Ndërsa, për sa i përket pretendimit të subjektit se shuma 400.000 lekë e marrë hua është krijuar nga dy kreditë e marra nga huadhënësja R. M., konstatohet se: *së pari*, ky pretendim deformon burimin e krijimit të kësaj shume të deklaruar prej vetë huadhënësës në deklaratën

²² Shkresën e “Raiffeisen Bank”, “Kthim përgjigje” nr. {***} prot., datë 02.02.2023.

noteriale të cituar më lart, në të cilën ajo vetëdeklaroi se si burim për krijimin e shumës 400.000 lekë kanë shërbyer të ardhurat e saj dhe bashkëshortit prej punësimit të tyre. *Së dyti*, nga analizimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, konstatohet se një nga kreditë është disbursuar në datën 28.12.2005, një ditë pasi bashkëshortja e ndjerë e subjektit ka kredituar llogarinë e saj bankare me shumën 12.500 euro. Nisur nga kjo situatë faktike, trupi gjykues çmon se ajo nuk mund të përfshihet si burim i krijimit të shumës 400.000 lekë. Shpjegimi që jep subjekti se kjo kredi ka shërbyer për të shlyer një hua afatshkurtër ndaj një kolegu të bashkëshortes, marrë për këtë qëllim, vlerësohet si deklarativ dhe i pabesueshëm, i ngritur si pretendim vetëm pas konstatimit të kësaj anomalie lidhur me kohën e disbursimit të kredisë, për pasojë i pavlefshëm si një argument bindës. Trupit gjykues, pasi kontrolli analizën financiare të kryer nga Komisioni për familjen M., pa përfshirë kreditë e pretenduara prej subjektit, i rezultoi që ajo të jetë me një balancë negative prej (-)178.356 lekësh në kohën e dhënies së huasë, e cila edhe në rast se do përfshihej si ardhur nga kredia prej 200.000 lekësh, e disbursuar më parë dhënies së huas, do të korrektohte analizën financiare në një vlerë pozitive prej (+) 21.644 lekësh, e cila sërish e bën të pamundur justifikimin me burime të ligjshme të shumës së dhënë hua prej 400.000 lekësh.

17.16. Në përfundim, trupi gjykues, nga analiza financiare e kryer, çmon se siç ka evidentuar edhe Komisionerja Publike rezultoi se personi tjetër i lidhur dhe familja e saj nuk kishin të ardhura të ligjshme për të mundësuar dhënien e huas në shumën 400.000 lekë. Pretendimi i subjektit i ngritur më vonë gjatë hetimit administrativ, se si burim për financimin e kësaj huaje janë përdorur dy kredi të marra nga familja e huadhënëses në vlerën totale të huas, u gjend nga trupi gjykues, përveçse një burim i deklaruar vetëm në nevojën e justifikimit të të ardhurave të familjes M. në një fazë të avancuar të hetimit dhe në kontradiktoritet me deklaratimet e mëparshme, por edhe i pabesueshëm në kushtet ekonomike të një familjeje me të ardhura modeste e, për më tepër, në kontekstin e ngarkimit të saj me detyrimin për pagimin e interesave që lindin nga marrëdhëniet e kredisë, si edhe kohës së përfitimit të tyre. Në këto kushte, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dështoi të provojë, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, se huadhënësja R. M. kishte të ardhura të ligjshme për të mundësuar dhënien e kësaj huaje.

17.17. Trupi gjykues mori në analizë edhe pretendimet e ngritura në ankim nga Komisionerja Publike lidhur personin tjetër të lidhur, znj. M. D., e cila është motra e subjektit të rivlerësimit, *sipas të cilave, deklaratimet kontradiktore mbi huan në vlerën 1.000.000 lekë dhënë nga kjo huadhënëse, vënë në dyshim ligjshmërinë e kësaj të fundit*, duke analizuar sa vijon:

17.18. Nga përmbajtja e vendimit objekt shqyrtimi, rezulton se Komisioni është ndalur vetëm në analizimin e mundësive financiare të personit tjetër të lidhur, znj. M. D., për justifikimin e shumës prej 1.000.000 lekësh të dhënë hua bashkëshortes së ndjerë të subjektit, duke konkluduar në përfundim se ajo dhe familja e saj kanë pasur të ardhura të ligjshme për të mundësuar dhënien hua të kësaj shume. Komisioni nuk ka analizuar në mënyrë të veçantë deklaratimet e subjektit në raport me këtë marrëdhënie, në drejtim të besueshmërisë së ekzistencës së saj dhe në këndvështrimin e ngritur në ankim prej Komisioneres Publike. Të vetmet konstatime të Komisionit të kësaj natyre janë ato të përgjithshme që lidhen me pasaktësitë e subjektit në deklaratimet periodike për deklarimin e blerjes së aksioneve dhe burimin e krijimit

të tyre, të cilat janë konsideruar pa peshë për sa kohë nuk shoqërohen me mungesë të burimeve të ligjshme.

17.19. Në këtë kuptim, trupi gjykues shqyrtoi pretendimin e Komisioneres Publike nën dritën dhe analizën e të dhënave që kanë rezultuar nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ. Subjekti i rivlerësimit në prapësim të pretendimit të Komisioneres Publike, lidhur me këtë marrëdhënie gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, ka deklaruar se ajo ka ekzistuar edhe për shkak të një njohjeje të afërt të bashkëshortes së ndjerë dhe motrës së tij për shkak se kishin ndjekur shkollën së bashku dhe njiheshin edhe më parë se të krijohej lidhja familjare. Ai ka risjellë në vëmendje se familja e motrës së tij kishte mundësi financiare t'i krijonte ato para pasi përveç pagës së motrës, familja ka siguruar të ardhura nga aktiviteti tregtar bar-kafe, nga aktiviteti në bujqësi në rrethin e Kukësit, si dhe në atë periudhë kanë marrë hua nga persona të tretë, një pjesë e së cilës ka shkuar edhe për dhënien e huas bashkëshortes së ndjerë të subjektit.

17.20. Trupi gjykues, në analizë të këtij shkakut ankimi, vlerëson të rendisë deklaratimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me këtë marrëdhënie, krahas deklaratimeve të motrës së tij, personit tjetër të lidhur, në deklaratat noteriale, të cilat iu nënshtuan analizës në funksion të dhënies përgjigje të pretendimit për pabesueshmërinë e ekzistencës së kësaj marrëdhënieje.

i. Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* huanë e marrë prej motrës së tij në shumën prej 1.000.000 lekësh, si burim për blerjen e aksioneve të shoqërisë {***} ShA.

ii. Nuk ka deklaruar këtë burim në deklaratën periodike të vitit 2006, megjithëse deklaroi se ka marrë dijeni mbi ekzistencën e kësaj marrëdhënieje huaje pas ndarjes nga jeta të bashkëshortes së tij, ngjarje që ka ndodhur në qershor 2006.

iii. Nuk e ka deklaruar marrëdhënien e huasë si burim as në deklarin origjinar të të dhënave në deklaratën periodike të vitit 2007, të dorëzuar në ILDKPKI në datën 28.02.2008, ndonëse ka deklaruar aty faktin se bashkëshortja kishte marrë prej motrës së saj një pjesë të parave për të financuar blerjen e aksioneve. Pra, duket se subjekti është vënë në dijeni për huan e bashkëshortes së ndjerë ndaj motrës së saj përpara se të vihej në dijeni për huan e bashkëshortes ndaj motrës së tij, ndonëse në vlera është më shumë se dyfishi i së parës.

iv. Ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2007, nëpërmjet shënimeve të kryera në datën 20.11.2008, jashtë afatit të deklaratimit, të dhëna shtesë për një marrëdhënie huaje me motrën, pa specifikuar se për motrën e cilit prej bashkëshortëve deklaroi e duke sugjeruar *a prima facia* se shpjegon më në detaje huanë e deklaruar prej motrës së bashkëshortes, në deklaratën e dorëzuar brenda afatit të deklaratimit. As në këtë deklarin, subjekti nuk ka identifikuar motrën e tij, znj. M. D., si personi që ka dhënë hua shumën prej 1.000.000 lekësh. Këto deklarime rezultojnë të jenë dhënë prej subjektit, pasi ILDKPKI-ja e ka thirrur për të sqaruar e dhënë shpjegime për deklaratimet e tij në deklaratat periodike edhe rreth këtij fakti.

v. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI më datë 20.11.2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Pas vdekjes së bashkëshortes në vitin 2006 jam vënë në dijeni nga {***} ShA se bashkëshortja F. T. ka pasur aksione në shumën 12.500 euro. Si burim për krijimin e kësaj shume sqaroj se bashkëshortja që në vitin 2005 ka marrë pa dijeninë time një huamarrje në shumën 1.400.000 lekë dhe konkretisht motrës së saj R. S. në shumën 400.000 lekë dhe motrës sime M. D. në shumën 1.000.000 lekë. [...] Nga këto shuma kam shlyer total detyrimin ndaj kunatës R. S. në shumën 400.000 lekë në vitin 2006. Detyrimi ndaj motrës në shumën 1.000.000 lekë ka zbritur pasi motra më ka falur një pjesë të detyrimit në shumën 400.000 lekë dhe kam*

shlyer shumën 200.000 lekë ndërsa vazhdon detyrimi i mbetur ndaj motrës në shumën 400.000 lekë. Deklarimet për detyrimin ndaj motrës së tij e ka shënuar edhe në DVP-në e vitit 2007, por pa përcaktuar se kujt i përkasin.

vi. Përgjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si provë dy deklarata noteriale të përpiluara nga motra e tij M. D. përkatësisht: me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.11.2022; deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.12.2022, redaktuar nga noteri publik, z. L. D., në të cilat ajo deklaron përkatësisht: **(a)** në deklaratën noteriale të datës 12.11.2022 [...] nga kjo shumë (duke iu referuar huas së dhënë prej 1.000.00 lekë) vëllai im, Naim Tota më ka kthyer në vitin 2006 shumën prej 200.000 lekë, shumën prej 400.000 lekë, vëllai im ma ka kthyer në vitin 2009 (me sa mbaj mend unë); **(b)** ndërsa në deklaratën noteriale të datës 03.12.2022, M. D. deklaron se shumën prej 400.000 lekësh deklaroj se ia kam falur [...], ndërsa përpara të njëjtit noter deklaron se [...] kjo shumë (duke iu referuar huasë së dhënë prej 1.000.000 lekësh) më është kthyer totalisht nga vëllai im, Naim Tota, në vitin 2010.

17.21. Nisur nga deklaratimet e pasqyruara më lart, në vlerësimin e trupit gjykues gjendet i drejtë pretendimi i Komisioneres Publike se subjekti nuk provoi ekzistencën e kësaj marrëdhënieje huaje, e cila shfaqet në deklaratime të paqarta e kontradiktore në të gjitha format e saj, prej subjektit të rivlerësimit, por edhe prej vetë huadhënëses, znj. M. D..

17.22. Në analizë të të gjithë situatës faktike të evidentuar më sipër, e cila nuk ndryshoi nga shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, trupi gjykues vlerëson se referuar fakteve që lidhen me: **(i)** mungesën e deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit për krijimin e kësaj pasurie në DVP-të e viteve 2005 e 2006; **(ii)** deklaratimet në DVP-në e vitit 2007 në mënyrë të pjesshme e të paplotë, duke krijuar paqartësi për burimin e krijimit të shumës së përdorur për blerjen e aksioneve në vlerën 12.500 euro; **(iii)** përfshirjen me vonesë të huasë së pretenduar të marrë prej motrës së tij si burim për krijimin e kësaj pasurie vetëm pas pyetjes dhe kërimit të shpjegimeve në ILDKPKI, nëpërmjet shënimeve shtesë në deklaratën periodike të vitit 2007 të bëra sipas shënimeve në datën 20.11.2008; **(iv)** mosdeklarimin e shlyerjes së një pjese të kësaj huaje në vitin 2006, ashtu siç subjekti pretendon; **(v)** deklaratimet kontradiktore të motrës së subjektit gjatë hetimit administrativ rreth mënyrës së shlyerjes së huasë; **(vi)** vlerësimin si të pabesueshëm të pretendimit të subjektit se ai ka qenë në padijeni të faktit se bashkëshortja e tij e ndjerë kishte investuar në blerjen e këtyre aksioneve, në vlerën 12.500 euro, trupi gjykues arriti në konkluzionin se pretendimi i Komisioneres Publike se kjo marrëdhënie huaje nuk provohet se ka ekzistuar, është i drejtë. Trupi gjykues çmoi se subjekti i rivlerësimit dështoi në këtë mënyrë të provojë ligjshmërinë e të ardhurave në vlerën prej 1.000.000 lekësh, të cilat pretendoi se kanë shërbyer për financimin e blerjes së aksioneve.

17.23. Në konkluzion, lidhur me këtë çështje, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dështoi të provojë burimet e ligjshme të përdorura për blerjen e aksioneve te shoqëria {***} ShA në vitin 2005. Në reflektim të këtij konkluzioni, në analizën financiare të kryer, rezulton se subjekti i rivlerësimit në vitin 2005 ka mungesë të burimeve të ligjshme për të përballuar investimet dhe shpenzimet e kryera në këtë vit, në vlerën prej (-) 1.927.339 lekësh, duke u gjendur në situatën që kualifikohet sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

18. Trupi gjykues mori në shqyrtim edhe pretendimet e Komisioneres Publike nëpërmjet të cilave kundërshtoi si jo të drejtë dhe në përputhje me situatën faktike analizën financiare të bërë nga

Komisioni për periudhën 2003-2016 për verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me të ardhura të ligjshme investimet e kryera dhe kostot e jetesës, e cila sipas Komisioneres Publike ka pasaktësi në disa zëra të cilët janë përlllogaritur jo sipas standardeve të organeve të rivlerësimit të aplikuara deri tani.

18.1. Komisioni, pasi ka kryer analizën financiare të familjes së subjektit të rivlerësimit për periudhën 2003-2016, ka arritur në konkluzionin se: [...] subjekti rezulton me një balancë negative në vitet 2004, 2005, 2006, 2007 dhe 2009 për një total të akumuluar prej (-) 1.577.274 lekësh, nga ku evidentohet se me balancë negative të konsiderueshme paraqiten vitet 2005, 2006 dhe 2007, vite për të cilat subjekti pretendon se ka pasur pasaktësi në deklarimin e likuiditeteve cash, si dhe viti 2009, për të cilin subjekti pretendon të reflektohen të ardhurat e deklaruar nga interesat e huasë. Kjo balancë, më pas nga Komisioni është vlerësuar se nuk është e mjaftueshme për të vendosur subjektin nën parashikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

18.2. Komisionerja Publike, në ankim dhe gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, ka kundërshtuar analizën financiare të kryer nga Komisioni, duke pretenduar se diferenca negative e konstatuar nga Komisioni është edhe më e lartë, pasi: (i) subjekti nuk arriti të provojë burimet e ligjshme të personit tjetër të lidhur R. M.²³ për huanë në shumën 400.000 lekë; (ii) për shkak të deklarimeve kontradiktore mbi huanë në vlerën 1.000.000 lekë deklaruar si e dhënë nga e motra e subjektit, znj. M. D., vihet në dyshim ligjshmëria e kësaj shume; (iii) ka pasaktësi në zërin e shpenzimeve të jetesës për vitin 2007, të cilat janë konsideruar jo në përputhje me standardin e përdorur deri tani nga institucionet e rivlerësimit, bazuar në korrespondencën me ILDKPKI-në; (iv) ka pasaktësi në shpërndarjen sipas viteve të të ardhurave të përfituara nga pensioni familjar për fëmijët, të cilat duket se janë shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme nga Komisioni për vitet 2006-2016, ndërkohë që nga verifikimi i korrespondencës me institucionet financiare duket se në vitin 2011 ka kaluar në llogarinë e subjektit pranë “Intesa Sanpaolo Bank” një pjesë e akumuluar e shumës, shuma të cilat nëse do të rishikohen do të thellojnë diferencën negative të viteve respektive; (v) diferenca negative²⁴ e analizës financiare prej (-)1.577.274 lekësh do të jetë më e lartë nëse do të shtohet dhe diferenca e konstatuar nga analiza financiare e bërë në datën 16.03.2016 prej (-) 342.054 lekësh, që përkon me momentin e shlyerjes së pagesës për blerjen e pasurisë “apartament banimi në Tiranë”. Për sa më sipër, Komisionerja Publike, në ankim dhe gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, ka pretenduar se i gjithë rezultati financiar i përftuar nga konsiderimi i çështjeve të sipërcituara tejkalon dhe nuk justifikon në mënyrë objektive masën e proporcionalitetit të zbatuar deri tani nga Kolegji në raste të ngjashme.

18.3. Në funksion të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues, duke konsideruar konkluzionet e mësipërme për pamundësinë financiare të huadhënëses, znj. R. M., si dhe atë lidhur me dështimin e subjektit për të provuar ekzistencën e marrëdhënies së huasë me motrën e tij, znj. M. D., vijoi kontrollin e analizës financiare²⁵ për periudhën 2003-2016, sipas

²³ Në kartën e identitetit bashkëlidhur me deklaratën noteriale të dhënë para noterit më datë 11.11.2022 figuron me emrin R. M., ndërsa në vërtetimet për bazën e vlerësueshme, të lëshuara nga punëdhënësit identifikohet me emrin R. M..

²⁴ Bazuar edhe në praktikën gjyqësore të Kolegjit, konkretisht, vendimet (JR) nr. 38/2021, nr. 19/2022, nr.18/2021 dhe nr. 31/2020.

²⁵ Kolegji për efekt të pasqyrimin të metodologjisë së aplikuar prej tij sqaron se kjo analizë financiare është bazuar në dokumentacionin e administruar dhe të vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja, deklaratat e interesave pasurore

pretendimeve të Komisioneres Publike, për verifikimin e rasteve kur subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme²⁶ pasuritë²⁷ (të luajtshme, të paluajtshme dhe likuiditete) e krijuara dhe shpenzimet²⁸ e kryera.

18.4. Trupi gjykues shqyrtoi pretendimin e Komisioneres Publike se ka pasaktësi në zërin e shpenzimeve të jetesës për vitin 2007, i cili është përlllogaritur jo në përputhje me standardin e përdorur deri tani nga institucionet e rivlerësimit bazuar në korrespondencën me ILDKPKI-në²⁹ dhe konstatoi se në tabelën e analizës financiare të hartuar nga Komisioni vlera e shpenzimeve të jetesës për vitin 2007 është llogaritur jo në përputhje me të dhënat e INSTAT-it, të përcjella në Kolegj nëpërmjet korrespondencën zyrtare me ILDKPKI-në. Nga ana e Komisionit është përcaktuar si shpenzim vlera prej 683.100 lekësh që korrespondon me shpenzimet e jetesës të përcaktuara sipas INSTAT-it për vitin 2008 për një familje me 5 persona, e cila është e ndryshme nga shifra prej 1.179.840 lekësh, që i përket vitit 2007, sipas së njëjtës korrespondencë.

18.5. Nisur nga kjo situatë faktike, trupi gjykues e gjen të drejtë pretendimin e Komisioneres Publike. Në këtë kontekst, trupi gjykues sjell në vëmendje se Kolegji në jurisprudencën e tij ka përcaktuar se metodologjia për të identifikuar kostot e jetesës për periudhën 2003-2016 do t'i

private/vjetore, deklarata vetting, pyetësorët me përgjigjet e subjektit, si dhe korrespondenca e Komisionit me institucionet publike dhe jopublike, si dhe nga vetë subjekti i rivlerësimit.

²⁶ Në këtë analizë si të ardhura të ligjshme janë konsideruar:

- Të ardhurat e ligjshme (neto), sipas vërtetimeve të lëshuara nga institucionet publike për subjektin e rivlerësimit, bashkëshorten aktuale, bashkëshorten e ndjerë, për të cilat janë deklaruar dhe paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- Të ardhurat nga pensioni familjar për fëmijët përfituar nga humbja e jetës së bashkëshortes F. T..
- Të ardhurat nga pensioni i pleqërisë së nënës së subjektit të rivlerësimit.
- Të ardhura nga shpërblimi i përfituar për fatkeqësi, sipas dokumentacionin të disponuar në fashikull.
- Të ardhurat nga interesat 1.5 % / muaj (600 euro/muaj) e huadhënies së pretenduar nga subjekti ndaj shtetasit T. H. në shumën 40.000 euro nuk janë pasqyruar në analizën financiare.

²⁷ Në këtë analizë për analizimin e pasurisë dhe detyrimeve u morën në konsideratë:

- Pasuria, e llojit apartament banimi me sip. 102,5 m², e ndodhur në Tiranë, rruga “{***}” në vitin 2016 është pasqyruar në analizë financiare 50.000 USD si e paguar nga subjekti sipas çmimit të përcaktuar në dokumentacionin ligjor të lidhur midis tij dhe shtetasit T. H. në këtë vit.
- Aksionet e shoqërisë {***} ShA janë reflektuar në vlerën 12.500 euro si të blera/investuara nga subjekti dhe personi i lidhur në vitin 2005.
- Detyrime ndaj huadhënësve M. D. dhe R. S., sipas konkluzioneve të mësipërme të këtij vendimi.
- Kursimet cash në banesë apo likuiditetet në bankë për shtesat/pakësimet vjetore, janë konsideruar duke analizuar Deklarimet e Interesave Periodike Vjetore dhe dokumentacionin ligjor justifikues të burimit të deklaruar të krijimit dhe destinacionin e tyre, sipas sqarimeve të dhëna në rezultatet e hetimit dhe në rezultatet shtesë të hetimit.

²⁸ Në këtë analizë si shpenzime janë konsideruar:

- Shpenzimet e jetesës, për vitet 2012 – 2016 u bazuan në shpenzimet e përcaktuara në raportin që ILDKPKI-ja ka përcjellë në Kolegj, me shkresën nr. {***} prot., datë 04.03.2019, të aplikuar deri aktualisht nga Kolegji.
- Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit, u analizuan bazuar në të dhënat e TIMS, sipas metodologjisë së Kolegjit.
- Shpenzimet për shlyerjen e detyrimeve për kthimin e huasë së marrë nga M. D. dhe R. S. (R. M.) janë konsideruar sipas deklarimeve të subjektit.
- Shpenzimet për pagesat e kredisë ndaj EKB-së janë konsideruar, sipas përcaktimit në dokumentacionin financiar përkatës.

²⁹ Kolegji ka kërkuar nga ILDKPKI-ja t'i vërë në dispozicion metodologjinë e aplikuar ndër vite për të përcaktuar kostot e jetesës për frymë për subjektet deklarues të pasurisë. Në përgjigje të kësaj kërkesë ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 04.03.2019, ka shpjeguar se këto shpenzime janë bazuar në të dhënat e INSTAT për shpenzimet e përvitshme duke i identifikuar shpenzimet për frymë të aplikuara nga ky organ nga viti 2003 e deri në vitin 2019.

referohet korrespondencës me ILDKPKI-në, e cila ka përcjellë si standard të zbatueshëm të dhënat që INSTAT ka identifikuar si kosto jetese për këtë periudhë, të cilat për më tepër përfaqësojnë nivele bazike të shpenzimeve të jetesës. Për këtë arsye, trupi gjykues aplikimin nga Komisioni i kostove më të ulëta të jetesës për familjen e subjektit të rivlerësimit në vitin 2007 e gjen të pabazuar, të paargumentuar dhe jashtë standardit të aplikuar deri aktualisht nga ky organ, gabim i cili u korrigjua në zërat e analizës financiare të kryer në Kolegj, në përgjigje të këtij shkaku ankimi.

18.6. Lidhur me pretendimin e Komisioneres Publike për shpërndarjen e pasaktë të disa të ardhurave të përfituara nga pensioni familjar për fëmijët e subjektit, trupi gjykues, nga analizimi i akteve të administruara nga hetimi administrativ, konstatoi disa të dhëna si në vijim: **(i)** nga shkresa e emërtuar “vërtetim” e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (në vijim “ISSh”), me nr. {***} prot., datë 26.10.2016, konfirmohet fakti se E. & B. T. (fëmijët e subjektit të rivlerësimit) kanë dosje me nr. {***} dhe janë trajtuar me pension familjar nga e ndjera znj. F. T. (nëna e tyre). Të ardhurat e pensionit familjar nga 20.06.2006-30.06.2015 janë në total 951.413 lekë. Referuar analizës financiare të Komisionit, konstatohet se këto të ardhura janë shpërndarë nga viti 2005-2016 në një shumë totale prej 951.413 lekësh, ndërkohë që vlera duhet të shpërndahej deri në qershor të vitit 2015; **(ii)** nga të dhënat bankare (statementi i lëshuar nga “Intesa Sanpaolo Bank”) rezulton se gjatë vitit 2011, në llogarinë me nr. {***} të z. Naim Tota, janë derdhur me përshkrimin “*DRSSh ka kaluar pensione*” shuma totale 217.111 lekë, ndërsa deri në gusht të vitit 2012 shumën prej 76.614 lekësh; **(iii)** nga shkresa me nr. {***} prot., datë 14.09.2020, e lëshuar nga ISSh, Drejtoria e Burimeve të Informacionit, konfirmohet se vajza e subjektit E. T. ka përfituar pension familjar me masë mujore përfundimtare për periudhën tetor 2017 - shtator 2019 në masën 9.825 lekë, ndërsa djali i tij B. T. ka përfituar pension familjar me masë mujore aktuale për periudhën nga nëntori 2017 e në vijim në masën 10.221 lekë. Në fashikull për periudhën 2011-2012 nuk disponohet informacion tjetër referuar pagesave të kryera nga ISSh-ja pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, situatë e cila e vështirëson ndarjen e saktë të shumës së deklaruar si të përfituar nga ky burim (pension i familjar).

18.7. Për shkak të kësaj shtate faktike, Komisionerja Publike pretendon se shpërndarja e kryer nga Komisioni për të ardhurat e pensionit familjar nuk është e saktë, pasi në vitin 2011 rezulton të ketë një derdhje në një shumë më të madhe se shuma e reflektuar në analizën e Komisionit. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj nuk solli akte të reja, të cilat të jepnin një informacion shtesë lidhur me pensionin familjar nga ato të indikuara më lart, në Kolegj u përlllogarit shpërndarja e këtij pensioni duke reflektuar ndryshimin që japin të dhënat bankare (statementit i “Intesa Sanpaolo Bank”), kryesisht për vitin 2011, në shumën prej 217.111 lekësh, e cila ka reduktuar vlerat e viteve paraardhëse 2010 dhe pjesërisht 2009. Gjithashtu, në analizën e kryer për të ardhurat e pensionit familjar, mbështetur në vërtetimin e lëshuar nga ISSh-ja, kjo e ardhur është shtrirë deri në vitin 2015. Në këtë analizë shuma mujore e pensionit e përfituar deri në mesin e vitit 2012 ka qenë 9.500 lekë/muaj, ndërsa më pas shuma ka ndryshuar në masën 9.807 lekë/muaj. Mbi bazën e këtyre të dhënave dhe kësaj analize, janë përcaktuar dhe shumat vjetore të pensioneve të përfituara për gjithë periudhën 2006-2015, të cilat u reflektuan në analizën financiare të kryer në Kolegj, në funksion të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi.

18.8. Krahas korrektive të kryera për shkak të qëndrimeve të mësipërme, trupi gjykues, ashtu si edhe Komisioni, konfirmon se në datën 16.03.2016 në momentin e pagimit të çmimit të apartamentit në rrugën “{***}”, në Tiranë, bazuar në kontratën e cedimit, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme në shumën (-) 342.054 lekë. Në analizë të këtij shkakut ankimi të ngritur nga Komisionerja Publike, trupi gjykues konstaton se diferenca negative në vitin 2016 prej (-) 342.054 lekësh nuk ka gjetur reflektim në të gjithë analizën financiare të kryer nga Komisioni, i cili për të gjithë periudhën 2003-2016 ka evidentuar një diferencë totale të pambuluar me burime të ligjshme në shumën prej (-) 1.577.274 lekësh, të cilës nëse do t’i shtohej diferenca negative e vitit 2016 në masën (-) 342.054 lekë do të rezultonte në total në vlerën (-) 1.919.328 lekë edhe pa reflektuar asnjë prej konkluzioneve të analizuar më sipër.

18.9. Pavarësisht këtij konkluzioni matematikor, trupi gjykues vlerësoi se subjekti nuk duhet të ngarkohet me këtë balancë negative në vitin 2016, përderisa konkluzioni i arritur prej këtij gjykimi ishte ai i arsyetuar më sipër se subjekti realisht e ka blerë dhe financuar vetë pasurinë e apartamentit në vitin 2003 dhe e gjithë pesha financiare për këtë veprim do të duhej të ngarkonte analizën e këtij viti. Në kushtet kur trupa gjykuese nuk i gjeti të besueshme faktet e deklaruara nga subjekti për blerjen e apartamentit në vitin 2016, përfshirja në analizën financiare të këtij viti të shpenzimit për blerjen e këtij apartamenti do të përbënte një *non-sens* logjik, prandaj trupi gjykues e konsideron këtë pretendim të Komisioneres Publike si të pabazuar.

18.10. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim pretendimin e Komisioneres Publike lidhur me analizën financiare të kryer në Komision, e cila është kontestuar si më lart analizuar, në drejtim të shpenzimeve të jetesës për vitin 2007, si dhe për shpërndarjen në vite të të ardhurave të përfituara nga pensioni i fëmijëve, pretendime të cilat u reflektuan në përputhje me situatën faktike që ka rezultuar nga hetimi në Komision për periudhën 2003-2016, korrigjoi rezultatin e nxjerrë nga Komisioni në këtë analizë për sa vijon.

Nga analiza e kryer në Kolegj, duke reflektuar ndryshimet e mësipërme³⁰ për analizën e viteve 2004, 2005, 2006, 2007 dhe 2009, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për të mbuluar investimet dhe shpenzimet e kryera në këto vite, në total në vlerën (-) 3.472.557 lekë, duke u gjendur sërish në situatën që kualifikohet sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 19.** Lidhur me pretendimin e Komisioneres Publike se *subjekti i rivlerësimit në deklaratën vetting, si dhe në deklaratimet periodike vjetore ka bërë deklaram të pasaktë për pasurinë tokë bujqësore në pronësi të tij, të përfituar nga ligji nr. 7501, si dhe për pasuritë e paluajtshme të personave*

³⁰ Sipas analizës së kryer në Kolegj, për pretendimet e Komisioneres Publike, duke konsideruar çështjet e trajtuara më sipër lidhur me huatë, diferenca negative e mbulimit të shpenzimeve, investimeve me të ardhura të ligjshme për subjektin e rivlerësimit në vitet 2004, 2005, 2006, 2007 dhe 2009 do të rezultonte si vijon:

- viti 2004 (-) 69.719 lekë;
- viti 2005 (-) 1.927.339 lekë në kushtet kur nuk u konsiderua huaja e pretenduar si e dhënë nga motra e subjektit M. D.;
- viti 2006 (-) 534.540 lekë;
- viti 2007 (-) 492.404 lekë, duke përfshirë shpenzime jetese sipas analizës së Kolegjit;
- viti 2009 (-) 194.725 lekë;
- datë 16.03.2016 (-) 342.054 lekë.

të lidhur, (fëmijëve të tij), të cilat i kanë përfituar me zëvendësim nga trashëgimia ligjore e gjyshit të tyre, trupi gjykues konstaton dhe analizon sa vijon.

19.1. Komisioni, lidhur me faktin që subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* pasurinë tokë bujqësore të fituar nga ligji nr. 7501, e ka konsideruar atë si deklaram të pasaktë sipas leximit *a contrario* të pikës 5, shkronja “a” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe pa peshë në procesin e rivlerësimit, përderisa këtë pasuri e ka deklaruar nëna e tij, si person i lidhur në këtë deklaratë dhe në konsideratë të faktit që ajo është fituar për shkak të ligjit. Ndërsa, lidhur me mosdeklarimin në këtë deklaratë të pasurive të paluajtshme të fituara prej fëmijëve të tij me trashëgim, ka pranuar se për shkak të faktit se ai me cilësinë e kujdestarit ligjor të tyre ka hequr dorë nga kjo pasuri trashëgimore ka qenë në padijeni të faktit se pasuritë gjendeshin ende të regjistruara në emër të fëmijëve të tij në kohën e përpilimit të deklaratës *vetting*, për pasojë mosdeklarimi i tyre nuk konsiderohet me peshë në procesin e tij të rivlerësimit.

19.2. Komisionerja Publike ka pretenduar se *nuk ka asnjë rrethanë ligjore të vlefshme që subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, të mos deklaronin saktësisht dhe mjaftueshmërisht pasuritë e tyre në pronësi dhe bashkëpronësi.* Për shkak të mosdeklarimit të këtyre pasurive në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit së bashku me personat e lidhur (fëmijët) ndodhen në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në kundërshtim kjo me përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

19.3. Nga analizimi i akteve të fashikullit të hetimit administrativ konstatohet se nëna e subjektit të rivlerësimit, e cila figuron në të njëjtën gjendje familjare me subjektin dhe, për rrjedhojë, në zbatim të përcaktimeve të nenit 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016 ka statusin e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, ka plotësuar shtojcën e deklaratës *vetting*, duke deklaruar se ka në pronësi pasuritë: (i) tokë bujqësore në zonën kadastrale nr. {***}, Njësia Administrative Bushtricë, me nr. pasurie {***}, me sip. 687 m², në fshatin {***} të rrethit Kukës; (ii) tokë bujqësore në zonën kadastrale nr. {***}, Njësia Administrative Bushtricë, me nr. pasurie {***}, me sip. 1437 m², në fshatin {***} të rrethit Kukës. Për këto pasuri, po në deklaratën *vetting*, nëna e subjektit të rivlerësimit ka shpjeguar se këto sipërfaqe toke nuk janë shfrytëzuar asnjëherë dhe rezultojnë në emër të bashkëshortit të saj të ndjerë, z. B. T., duke i bashkëlidhur kësaj deklarate vërtetimin e datës 09.01.2017 të lëshuar nga ZRVPP-ja Kukës.

19.4. Pasi Komisioni³¹ i ka kërkuar subjektit të deklarojë mbi mënyrën e përfitimit, burimin e krijimit dhe statusin aktual të këtyre pasurive, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se [...] këto toka janë përfituar me ligjin nr. 7501, të vitit 1991. Nuk është bërë çelja e trashëgimisë dhe për këtë shkak është në emër të babait të ndjerë, B. T.³².

19.5. Nga verifikimet që Komisioni ka kryer gjatë hetimit administrativ nga korrespondenca me ASHK Drejtoria Vendore Kukës³³ ka rezultuar se pasuritë tokë bujqësore, me nr. pasurie {***}, me sip. 687 m² dhe nr. pasurie {***}, me sip. 1437 m², me vendndodhje në fshatin {***} të rrethit Kukës, janë përfituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”,

³¹ Me pyetësin nr. 2.

³² Në mbështetje të shpjegimeve të bëra subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision shkresën nr. {***} prot., datë 10.11.2022, të ASHK Drejtoria Vendore Kukës.

³³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 08.11.2022.

me AMTP-në, datë 01.11.1991. Nga ky verifikim rezulton se duke qenë se subjekti ka qenë pjesë e familjes bujqësore të z. B. T. (babai i tij), për shkak të ligjit ai ka fituar të drejta pronësie mbi pjesët takuese të përcaktuara nga ligji mbi këto pasuri, të drejta të cilat nuk burojnë nga trashëgimia prej babait të tij, por drejtpërdrejtë nga zbatimi i ligjit.

19.6. Në shpjegimet që subjekti ka dhënë për rezultatet paraprake të hetimit administrativ, pasi është njohur me këtë konstatim të Komisionit, ai sërish ka mbajtur qëndrimin se pasuritë tokë bujqësore janë regjistruar në kadastër vetëm në emrin e babait të tij të ndjerë B. T.. Kjo ka ndodhur për shkak se babai, në atë kohë, ka qenë kryetar i familjes bujqësore dhe duke qenë i tillë, në regjistrat e kadastrës figuron i regjistruar vetëm ai dhe jo anëtarë të tjerë të familjes, një ndër të cilët ka qenë edhe vetë subjekti. Ndërkohë, më pas, në vitin 1992, ai është larguar me banim në qytet dhe nuk është marrë më me regjistrimin e këtyre pasurive.

19.7. Trupi gjykues konstaton se edhe pas shpjegimeve të dhëna nga subjekti gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, duke prapësuar se pretendimi i Komisioneres Publike se nuk ka deklaruar tokën e përfitur nga i ndieri babai i tij, në bazë të ligjit nr. 7501/1991 nuk qëndron, pasi ajo është deklaruar prej tij në deklaratën *vetting*, situata faktike e mosdeklarimit të këtyre pasurive prej subjektit në deklaratën *vetting*, mbetet e njëjtë me sa konstatuar më sipër. Në këto kushte, trupi gjykues për pasuritë të llojit tokë bujqësore me vendndodhje në fshatin {***}, Kukës, çmon se pretendimi i Komisioneres Publike se për këto pasuri nuk ka rrethana ligjore të vlefshme që të justifikojnë mosdeklarimin e tyre në këtë deklaratë është një konstatim i saktë, në përputhje me faktet dhe ligjin. Subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë bashkëpronar në tokën bujqësore të fituar me ligjin nr. 7501/1991 në mënyrë të drejtpërdrejtë, pavarësisht faktit se pasuria është regjistruar në emër të babait të tij, që ka qenë kryefamiljari i familjes bujqësore. Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë dhe përcaktimi i pjesës trashëgimore të subjektit në të, vetëm do të ndryshonte pjesët takuese të tij në këtë pasuri, duke i rritur ato, por nuk do të krijonte të drejta të reja për subjektin, të drejta të cilat janë krijuar me zbatimin e ligjit nr. 7501/1991.

19.8. Në vijim, trupi gjykues mori në shqyrtim edhe pretendimin e Komisioneres Publike, lidhur me pasaktësitë në deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe fëmijët e tij për pasuritë që këta të fundit kanë pasur në pronësi.

19.9. Nga të dhënat e akteve të administruara përgjatë hetimit administrativ në Komision, rezulton se në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*, sipas dokumentacionit të përcjellë nga ASHK, Drejtoria Vendore Kukës³⁴, fëmijët e subjektit të rivlerësimit kanë pasur në pronësi pjesë takuese në disa pasuri³⁵ të përfituara nëpërmjet trashëgimisë ligjore të gjyshit të tyre, z. M. M. (babai i nënës, i cili ka ndërruar jetë më datë 15.4.2007), duke u thirrur si trashëgimtarë ligjorë me zëvendësim, në vend të nënës së tyre, të paravdekur, të ndjerës F. T..

³⁴ Shkresë kthim përgjigjeje nr. {***} prot., datë 08.08.2022, e ASHK Drejtoria Vendore Kukës.

³⁵ (i) Pasuria me nr. {***} e llojit arë me sipërfaqe 3856 m², e ndodhur në Shtiqën, Kukës, në pronësi të G. M. 85,72 % ndërsa E., E. dhe B. T. nga 4,76 % secili; (ii) pasuria me nr. {***} e llojit arë me sipërfaqe 13674 m², e ndodhur në {***}, Kukës, në pronësi të G. M. 85,72 % ndërsa E., E. dhe B. T. nga 4,76 % secili; (iii) pasuria me nr. {***} e llojit arë me sipërfaqe 4406 m², e ndodhur në {***}, Kukës, në pronësi të G. M. 85,72 % ndërsa E., E. dhe B. T. nga 4,76 % secili; (iv) pasuria me nr. {***} e llojit arë me sipërfaqe 3612,5 m² e ndodhur në Shtiqën, Kukës, në pronësi të G. M. 85,72 % ndërsa E., E. dhe B. T. nga 4,76 % secili; (v) si dhe pasuria me nr. {***} e llojit truall me sipërfaqe 1322,5 m², dhe karburant me sipërfaqe ndërtimore 220 m², e ndodhur në {***}, Kukës, në pronësi të G. M. 83.33 % ndërsa E., E. dhe B. T. nga 5,56 % secili.

19.10. Në datën 20.11.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lëshuar autorizimin me nr. {***}, për tjetërsimin e pasurisë së fëmijëve të mitur në favor të subjektit të rivlerësimit Naim Tota. Në datën 19.12.2017, E. dhe B. T., kanë lëshuar një prokurë të përgjithshme³⁶, në të cilën i japin të drejta të plota shtetasit G. M. për të disponuar për të gjitha pasuritë e tyre të paluajtshme. Përveç sa më sipër, subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve paraprake të hetimit, lidhur me pasuritë e përfituara nga fëmijët e tij të mitur në vitin 2008, nëpërmjet trashëgimisë që vjen nga gjyshi i tyre, ka shpjeguar se me deklaratën noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.03.2009, redaktuar nga noteria znj. M. Ll., në cilësinë e bashkëshortit të shtetasës së ndjerë F. T. (M.) dhe njëkohësisht si babai i 3 fëmijëve të mitur E., E. dhe B. T. (të cilët janë trashëgimtarë me zëvendësim) ka deklaruar, ndër të tjera, se *si përfaqësues i fëmijëve të tij, se ata heqin dorë nga pasuria tokë bujqësore e fituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, nga F. T., si pjesëtarë të familjes në datën 01.08.1991 dhe, gjithashtu, heqjen dorë nga të gjithë pasuritë e fituara dhe ato që do të përfitohen nga ky ligj duke ja lënë në pronësi pjesën e tyre takuese vëllait të bashkëshortes së tij, z. G. M. (daja i fëmijëve të tij)*. Bazuar në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në Komision se ka qenë detyrim i dajës së fëmijëve të bënte veprimet përkatëse për këto pasuri në regjistrat e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe të regjistronte heqjen dorë prej fëmijëve e tij mbi këto pasuri.

19.11. Trupi gjykues, pasi dëgjoi edhe shpjegimet e dhëna nga subjekti gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj, të cilat rezultojnë të jenë të njëjta me shpjegimet e dhëna prej tij në Komision, në analizë të dispozitave ligjore në fuqi dhe në referim të të dhënave faktike në këtë rast, nuk konstatoi asnjë rrethanë ligjore që të zhvishte nga përgjegjësia ligjore subjektin edhe personat e lidhur nga detyrimi për deklarimin e këtyre pasurive në deklaratën *vetting*.

19.12. Referuar të dhënave dokumentare, rezulton se fëmijët e subjektit gëzonin të drejtat e bashkëpronësisë mbi pasuritë e fituara me trashëgim në momentin e përpilimit e dorëzimit të deklaratës *vetting*. Këto të drejta kanë humbur vetëm në vitin 2018, pasi daja i tyre G. M., si përfaqësues me prokurë i E., E. dhe B. T. më datë 04.12.2018 ka nënshkruar një deklaratë noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., me objekt “heqje dorë pa kundërshtëpërblim/falas nga bashkëpronësia mbi pasurinë e paluajtshme”³⁷. Në këto kushte ata kanë pasur detyrimin për deklarimin e tyre në deklaratën *vetting*. Deklarata nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.03.2009, e përdorur prej subjektit si argument se fëmijët e tij kishin hequr dorë nga trashëgimia, nëpërmjet deklarimit të tij me cilësinë e kujdestarit ligjor, vlerësohet nga trupi gjykues se nuk mund të prodhojë efektet e dëshiruara e të deklaruar në të. *Së pari*, ky akt është përpiluar në datën 23.03.2009, e cila është në distancë kohore nga data 10.08.2008, në të cilën është çelur trashëgimia ligjore e të ndjerit gjyshit të tyre, më shumë se tre muaj, afat të cilin e

³⁶ Prokurë e përgjithshme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.12.2017, redaktuar nga noteria E. T.

³⁷ Në datën 04.12.2018 E., E. dhe B. T., të përfaqësuar nga shtetasi G. M. kanë nënshkruar një deklaratë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., me objekt “heqje dorë pa kundërshtëpërblim/falas nga bashkëpronësia mbi pasurinë e paluajtshme”, e konkretisht për pasuritë me nr. {***} me sipërfaqe 1322,5 m² truall, karburant një kat me sipërfaqe ndërtimore 220 m², si dhe 3 nga 4 pasuritë e tjera në të cilat kishin pjesë takuese në listën me 5 prona të cituar në fillim të këtij seksioni e konkretisht e llojit: arë me nr. {***} (pasuria {***}) me sip. 13674 m², nr. {***} (pjesë e pasurisë {***}) me sip. 2916 m², nr. {***} (pjesë e pasurisë {***}) me sip. 3158,5 m², të gjitha këto pasuri i kalojnë bashkëpronarit tjetër të tyre G. M. në masën 100%.

përcakton neni 335, pika 1 e Kodit Civil³⁸. Në këto kushte, kjo deklaratë nuk plotëson kriterin ligjor të kohës për t'u konsideruar si heqje dorë nga trashëgimia. *Së dyti*, në referim të nenit 234 të Kodit të Familjes³⁹, heqja dorë nga trashëgimia për një fëmijë të mitur nga kujdestari i tij ligjor do të duhet të bëhet gjithmonë me autorizim të gjykatës, përndryshe ajo është e pavlefshme. Për të dy arsytet e mësipërme, heqja dorë e pretenduar prej subjektit nuk ka krijuar pasojat ligjore që ai pretendon, për pasojë detyrimi i tij dhe personave të lidhur për deklaram nuk zhbëhet për shkak të kësaj deklarate dhe, aq më tepër, që të ngarkojë me përgjegjësi personin përfitues për kryerjen e veprimeve në ZVRPP. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen të drejtë edhe këtë konstatim të Komisioneres Publike dhe ndan të njëjtin qëndrim me të mbi detyrimin e subjektit dhe personave të lidhur për të deklaruar në deklaratën *vetting* këto të drejta pasurore që ata i gëzonin në kohën e përpilimit të deklaratës.

19.13. Pavarësisht nga sa evidentuar më sipër, trupi gjykues konstatoi se fitimi i pronësisë prej subjektit të rivlerësimit mbi tokën bujqësore në zbatim të ligjit nr. 7501/1991 dhe fitimi i pronësisë së fëmijëve të tij mbi pasuritë që vinin me trashëgim nga gjyshi i tyre, për të cilat subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë bërë deklarime në deklaratën e pasurisë *vetting*, janë realizuar jashtë ndikimit dhe influencës së subjektit si magjistrat dhe nuk evidentohen rrethana që vënë në dyshim burimin e krijimit të tyre. Për këto arsye, trupi gjykues vlerësoi se konstatimet e mësipërme nuk do të jenë përcaktuese në procesin e rivlerësimit të subjektit.

19.14. Në përfundim, për këtë shkak ankimi, trupi gjykues e gjeti të drejtë pretendimin e Komisioneres Publike se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* këto pasuri, të cilat formalisht ishin në pronësi/bashkëpronësi të tyre në kohën e përpilimit të kësaj deklarate, duke u gjendur në këtë mënyrë në kushtet e një deklarimi të pasaktë dhe në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, gema "a" e ligjit nr. 84/2016. Pavarësisht këtij konkluzioni, trupi gjykues nuk vlerësoi se kjo pasaktësi do të kishte ndikim në vendimmarrjen për zgjidhjen e çështjes, për sa kohë që nuk evidentohen elemente që e vendosin subjektin dhe personat e lidhur në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

20. Në përfundim, në konsideratë të të gjitha qëndrimeve të mësipërme lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të pamjaftueshme për këtë kriter dhe gjendet nën parashikimet e nenit D, pikat 1, 3 e 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

ii. Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

21. Trupi gjykues mori në shqyrtim dhe analizoi edhe pretendimet e Komisioneres Publike lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, në raport me gjetjet që rezultojnë nga

³⁸ Heqja dorë nga trashëgimi mund të bëhet brenda 3 muajve nga çelja e trashëgimisë dhe kur trashëgimtari është jashtë shtetit, jo më vonë se 6 muaj.

³⁹ Tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të çdo fëmije të mitur deri në moshën tetëmbëdhjetë vjeç, lënia hipotekë, ngarkimi me një barrë, marrja hua në emër të të miturit, heqja dorë nga trashëgimia apo legu ose mospranimi i një dhurimi, si dhe përgjithësisht veprimet që kapërcejnë kufijtë e një administrimi të thjeshtë të çdo pasurie të të miturit, mund të kryhen vetëm kur e kërkon interesi i të miturit dhe me autorizim të gjykatës së vendbanimit të të miturit. Veprimi juridik, që është kryer pa u marrë autorizimi i gjykatës, mund të shpallet i pavlefshëm me kërkesën e prokurorit, të prindit ose të kujdestarit të të miturit. Në qoftë se gjykata jep pëlqimin më vonë, veprimi juridik nuk shpallet i pavlefshëm.

denoncimet e përcaktuara prej tij në ankim, për të cilat Komisionerja Publike pretendon se në shqyrtimin e procedimit penal nr. {***}, që lidhet me denoncimin e shtetasit Q. D., si dhe në shqyrtimin e procedimit penal nr. {***}, që i përket denoncimit të shtetasit A. M., subjekti i rivlerësimit në mënyrë të përsëritur, duke konsideruar edhe denoncimet e ardhura nga denoncuesit E. D., F. Y. dhe M. Z., ka treguar të meta të dukshme, mungesë arsytimi, mungesë hetimesh dhe mosrespektim të vendimmarrjes së gjykatave, mangësi këto që duhen vlerësuar në raport me përmbushjen e standardeve të përcaktuara nga nenet 73 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, dhe në vlerësimin në tërësi të çështjes në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

21.1. Në vendimin e Komisionit, lidhur me denoncimet e përcjella nga publiku, konstatohet se mungon analiza dhe konkluzioni për secilin prej tyre, por qëndrimi i tij lidhur me to është përmbledhur në një vlerësim të përgjithshëm nëpërmjet të cilit, ndonëse janë evidentuar disa mangësi lidhur me hetimin në disa raste, është konkluduar se shkeljet e pretenduara nga denoncimet e publikut nuk janë të tilla që të përbëjnë shkaqe për një vlerësim negativ të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, duke evidentuar, gjithashtu, se një pjesë e këtyre pretendimeve lidhen me themelin e zgjidhjes së çështjeve, të cilat janë objekt kontrolli gjyqësor dhe jo i Komisionit.

21.2. Komisionerja Publike lidhur me këtë kriter ka pretenduar se mangësitë e vërejtura në denoncimet e paraqitura nga publiku janë të natyrës vazhduese dhe të njëjta. Procedimet e marra në shqyrtim, përmbajnë të meta të dukshme, mungesë arsytimi, mungesë hetimesh dhe mosrespektim të vendimmarrjes së gjykatave, mangësi këto që duhen vlerësuar në raport me përmbushjen e standardeve të përcaktuara nga nenet 73 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, për sa i përket aftësisë për të hetuar, për të marrë urdhra dhe vendime. Këto mangësi përbëjnë bazë të mjaftueshme edhe për vlerësimin në tërësi të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

21.3. Trupi gjykues, në funksion të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, pasi mori në shqyrtimin denoncimin e z. Q. D. që lidhet me procedimin penal nr. {***} dhe denoncimin e z. A. M. që lidhet me procedimin penal nr. {***}, si dhe verifikoi edhe denoncimet e paraqitura në Komision nga shtetasit E. D., F. Y. dhe M. Z., konstatoi sa vijon.

21.4. Lidhur me denoncimin e shtetasit Q. D.⁴⁰, që i referohet procedimit penal nr. {***}, i ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se: **(i)** me vendimin e datës 04.04.2018, subjekti i rivlerësimit ka vendosur mos fillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. {***} të vitit 2018 të shtetasit Q. D.; **(ii)** me vendimin nr. {***} akti, datë 11.06.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur: “Shfuqizimin e vendimin e të datës 04.04.2018, për mos fillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. {***} të vitit 2018, duke urdhëruar regjistrimin e procedimit për veprën penale të “*Mashtrim*” e parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal”. Në këtë vendim është konkluduar se kërkesa ankimore e kallëzuesit Q. D. është e bazuar dhe se ndryshe nga sa ka arsyetuar prokurori në vendimin për mos fillimin e procedimit penal gjykata vlerëson se fakti i pretenduar nuk ka lidhje me proceset gjyqësore civile të zhvilluara midis kërkuarit Q. D. dhe BKT-së dhe se prokurori duhet t’i konsiderojë pretendimet dhe faktet e

⁴⁰ Ankesa nr. {***} prot., datë 07.05.2018; ankesa nr. {***} prot., datë 23.02.2021; ankesa nr. {***} prot., datë 22.02.2021; ankesa nr. {***} prot., datë 31.01.2019; si dhe ankesa nr. {***} prot., datë 10.06.2019.

paraqitura nga kallëzuesi si fakt penal. Në vendimin e gjykatës, gjithashtu, janë identifikuar edhe veprimet hetimore që duhet të kryejë prokurori i çështjes (në këtë rast subjekti i rivlerësimit), siç është sekuestrimi pranë Bankës dhe Shoqërive Siguruese të praktikës përkatëse dhe t'i ballafaqojë ato me pretendimet dhe provat e paraqitura nga kallëzuesi; **(iii)** më tej, rezulton se në zbatim të vendimit të mësipërm të gjykatës, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 02.07.2018, ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, për veprën penale “Falsifikim i vulave, i stampave dhe i formularëve”, i parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal. Pas regjistrimit të këtij procedimi penal, sërish subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesën për pushimin e çështjes penale nr. {***}, duke arsyetuar se *bazuar në parashtrimet e mësipërme, përcaktimit të faktit dhe të provave në hetim, organi procedues çmon se nuk ka prova që vërtetojnë faktin e ndodhur që parashikohet si vepra penale “falsifikimi i vulave i stampave ose i formularëve”, të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal;* **(iv)** në kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. {***}, duket se nuk gjen pasqyrim urdhërimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. {***} akti, datë 11.06.2018, sipas së cilit prokurori duhet të regjistrojë procedimin penal për veprën penale të “Mashtrimi” parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal dhe as kryerja e veprimeve hetimore të urdhëruara si sekuestrimi pranë shoqërive të sigurimit policat dhe ballafaqimin e tyre me pretendimet dhe provat e paraqitura nga kallëzuesi; **(v)** më tej, rezulton se Gjykata së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi mori në shqyrtim kërkesën e prokurorit për pushimin e procedimit penal nr. {***}, (kërkesa e dytë) me vendimin nr. {***}, datë 19.10.2020, çmoi sërish se hetimet janë të paplota, pasi asnjë nga detyrat e lëna nga vendimi i mëparshëm i gjykatës nuk është zbatuar, dhe urdhëroi sërish që të regjistrohet procedimi për veprën penale “Mashtrim” të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal.

21.5. Trupi gjykues, për sa më lart, vlerëson të drejtë konstatimin e Komisioneres Publike se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në ushtrimin e funksioneve, për sa kohë që në mënyrë të përsëritur nuk ka zbatuar urdhërimet e vendimit të gjykatës, në kundërshtim me detyrimin që vjen nga neni 332/ç i Kodit të Procedurës Penale.

21.6. Lidhur me denoncimin e z. A. M., nga analiza e akteve të administruara në fashikullin e Komisionit, konstatohet se: **(i)** me vendimin e datës 26.10.2017, subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal me nr. {***} të vitit 2017, që i përket kallëzimit të paraqitur prej denoncuesit; **(ii)** me vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë me nr. {***}, datë 24.04.2018, është vendosur “Ndryshimi i vendimit nr. {***} akti, datë 01.02.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pranimi i kërkesës. Shfuqizimi i vendimit datë 28.09.2017, të organit të prokurorisë “Për mosfillimin e procedimit penal që i përket kallëzimit penal nr. {***}, të vitit 2017” dhe kthimi i akteve atij organi për vazhdimin e hetimeve. Në këtë vendim, gjykata ka përcaktuar edhe veprimet e domosdoshme hetimore që duhet të kryhen nga organi i prokurorisë, si vijon: (1) të bëhen verifikime lidhur me instruktimin e punonjësve nga subjekti “{***}” ShPK ., midis tyre edhe për instruktimin e të dëmtuarit A. M., duke administruar, kopje të Procesverbalit të Instruktimit Teknik; (2) të bëhen verifikime nëse nga punëdhënësi (subjekti “{***}” ShPK) është informuar Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe, nëse po, të administrohet kopje e informacionit dhe regjistrimit të protokollit (neni 25/1/a/b, i ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”); (3) të bëhen verifikime nëse është bërë hetim administrativ i ngjarjes nga Drejtoria

Rajonale e Inspektoratit Shtetëror të Punës Tiranë dhe, nëse po, të administrohet dosja e këtij inspektimi së bashku me procesverbalin e rezultateve të hetimit administrativ (neni 27/1/d i ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”); (4) të bëhen verifikime nëse është mbajtur procesverbal për këtë aksident dhe, nëse po, a është raportuar ai në kohë në Drejtorinë Rajonale të Inspektoratit Shtetëror të Punës Tiranë, si edhe të administrohet praktika e dërgimit të këtij procesverbali (neni 30/2 i ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”); (5) të bëhen verifikime nëse është bërë inspektim lidhur me aksidentin në punë të datës 13.07.2017, në subjektin “{***}” ShPK , me të dëmtuar A. M. dhe, nëse po, të administrohet praktika e këtij inspektimi (neni 25 i ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”) si dhe; (6) të bëhen verifikime nëse subjekti “{***}” ShPK ka njoftuar brenda afatit ligjor Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe nëse ky subjekt është ndëshkuar administrativisht nga ana e këtij Inspektorati për ndonjë shkelje (nenet 22 dhe 33 të ligjit nr. 9634, datë 30.10.2006, “Për inspektimin e Punës”, i ndryshuar). Në vendimin e saj, Gjykata e Apelit ka argumentuar se kryerja e këtyre detyrave nga organi i prokurorisë do të ndihmojë këtë organ për të përcaktuar nëse në rastin konkret ndodhemi apo jo para veprës penale të “Shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë”, të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal dhe në varësi të sqarimit të këtij fakti do të merret më pas edhe vendimi përfundimtar për këtë çështje; **(iii)** pas këtij vendimi, Prokuroria e pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, për veprën penale të “Shkelje të rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal, ndaj personit nën hetim A. H.. Në vijim, në përfundim të hetimeve, Prokuroria ka kërkuar pushimin e këtij procedimi penal. Lidhur me këtë kërkesë, ndër të tjera, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. {***} akti, datë 11.11.2019, ka vendosur: (1) pranimin e kërkesës; (2) pushimin e çështjes penale nr. {***} akti, datë 01.08.2019, që i përket procedimit penal nr. {***}, për veprën penale të “Shkelje të rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal, ndaj personit nën hetim A. H., pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale; **(iv)** ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka ushtruar ankim shtetasi A. M. (viktima) dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 12.02.2020, ka vendosur: (1) ndryshimin e vendimit nr. {***} akti, datë 11.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (2) kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve për një afat prej 90 ditësh. Rezulton se organi i akuzës i ka qëndruar kërkesës për pushimin e procedimit penal me arsyetimin se nuk jemi përpara veprës penale të parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal, me pasojë plagosjen e rëndë të shtetasit A. M., për shkak se nga ana e personave të ngarkuar drejtpërdrejtë me respektimin e rregullave dhe marrjen e masave në zbatim të tyre nuk konstatohen shkelje që kanë ndikuar në ardhjen e pasojës. Ndërsa sa i përket veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, i bëhet me dije gjykatës se kjo çështje është veçuar dhe hetimet janë në vazhdim. Referuar vendimit, Gjykata e Apelit ka evidentuar mangësi në hetimin e çështjes, pasi ka konstatuar se për të verifikuar nëse janë instruktuar punonjësit e shoqërisë “{***}” ShPK , si dhe punonjësi i aksidentuar, janë dy akte ekspertimi teknik me konkluzione kontradiktore me njëri-tjetrin. Gjykata e Apelit ka vlerësuar se organi i akuzës duhet të bëjë një hetim të plotë më të thelluar në lidhje me faktin nëse dokumenti me logon “Prima” është nënshkruar apo jo nga viktima A. M.. Gjithashtu, sipas gjykatës nuk rezulton të jetë hetuar se kush ka qenë Drejtuesi Teknik i shoqërisë “{***}” ShPK ., në atë kohë (momentin e ndodhjes së aksidentit) apo ndonjë person në pozicion ekuivalent që ka për detyrë të bëjë instruktazhin dhe të orientojë punonjësit në punën e tyre.

21.7. Në analizë të të dhënave të mësipërme, rezulton se vetëm pas dhënies së vendimit nr. {***}, datë 22.05.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka nxjerrë urdhrin “Për kryerjen e veprimeve hetimore” të urdhëruara në këtë vendim të gjykatës. Nga aktet që subjekti ka paraqitur, vetëm një prej tyre, përkatësisht “Akti dëshmi mjekoligjore mbi ekzaminimin e shtetasit A. M.”, i cili i kategorizon dëmtimet si “*dëmtime të rënda të rrezikshme për jetën e të dëmtuarit*”, rezulton të jetë veprimi i vetëm hetimor i kryer nga subjekti i rivlerësimit përpara marrjes së vendimit të datës 28.09.2017 “Për mos fillimin e procedimit penal”. Ky fakt, si dhe evidentimi prej Gjykatës së Apelit i një sërë veprimesh hetimore të nevojshme për t’u kryer, të cilat rezultojnë se janë kryer rreth një vit pasi ka ndodhur ngjarja/dëmtimi i viktimës A. M. dhe vetëm pasi gjykata ka disponuar në mënyrë urdhëruese për to, evidenton mangësitë e subjektit në drejtim të aftësive profesionale. Këto mangësi të demonstruara në hetimin e kësaj çështje potencohen sërish në vendimin e Gjykatës së Apelit, i cili ndryshon vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor për pranimin e kërkesës së subjektit për pushimin e procedimit penal dhe urdhëron kryerjen e veprimeve të tjera hetimore duke e vendosur subjektin në kushtet e mos përmbushjes së detyrave të prokurorit për të hetuar e për të kryer në mënyrë të efektshme procedurat hetimore.

21.8. Situata të ngjashme për mungesë hetimesh, kryerjen e hetimeve të cunguara dhe moszbatim të urdhërimeve të vendimeve të gjykatave për kryerjen e hetimeve shtesë, po ashtu rezultojnë edhe në çështjet e trajtuara nga subjekti i rivlerësimit, të cilat janë identifikuar në denoncimet e paraqitura në Komision nga shtetasit E. D. (që i referohet me kallëzimit nr. {***}) , F. Y. (që i referohet procedimit nr. {***}, datë 10.09.2018) dhe M. Z. (që i referohet vendimit të mos fillimit të procedimit penal për kallëzimin nr. {***} të vitit 2018).

21.9. Në përfundim të analizës së këtyre gjetjeve, trupi gjykues arriti në konkluzionin se ndonëse ato qëndrojnë dhe evidentojnë mangësi në kriterin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, në drejtim të indikatorëve të parashikuar prej neneve 73 e 74 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ato nuk vlerësohen të mjaftueshme edhe në kuptim të analizës së kryer, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për ta kualifikuar atë nën parashikimin e nenit 61, pika 5 e këtij ligji.

22. Në përfundim, trupi gjykues, mbështetur në konkluzionin e arritur për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, çmon se ankimi i paraqitur prej Komisioneres Publike është i drejtë dhe, për pasojë, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 634, datë 10.03.2023, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Naim Tota, është një vendim i cili nuk është marrë në vlerësim të drejtë të provave të administruara gjatë hetimit e as në zbatim të drejtë të dispozitave ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit dhe, si i tillë, ai duhet të ndryshohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 634, datë 10.03.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Naim Tota.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 13.12.2023.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi